



Strasburg, 17.4.2018
COM(2018) 450 përfundimtar

**KOMUNIKIM NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,
KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE
KOMISIONIN E RAJONEVE**

**Komunikimi i vitit 2018 për Politikën e Zgjerimit
të BE-së**

{SWD(2018) 150 përfundimtar} - {SWD(2018) 151 përfundimtar} -
{SWD(2018) 152 përfundimtar} -
{SWD(2018) 153 përfundimtar} - {SWD(2018) 154 përfundimtar} -
{SWD(2018) 155 përfundimtar} -
{SWD(2018) 156
përfundimtar}

I. HYRJE

Në nëntor të vitit 2015, Komisioni Evropian përcaktoi një **strategji afatmesme për politikën e zgjerimit të BE-së**, e cila mbetet e vlefshme. Ky Komunikim shqyrton përparimin në zbatimin e politikës së zgjerimit deri në fund të janarit 2018, si dhe inkurajon vendet përkatëse që të vazhdojnë modernizimin e tyre përmes reformave politike dhe ekonomike, në përputhje me kriteret e anëtarësimit.

Procesi i zgjerimit vazhdon të ndërtohet mbi **kriteret e përcaktuara dhe kushtëzimin e drejtë dhe rigoroz**. Çdo vend vlerësohet në bazë të **meritave të veta**. Vlerësimi i përparimit të arritur dhe identifikimi i mangësive synojnë të ofrojnë stimuj dhe udhëzime për vendet, në mënyrë që të ndjekin reformat e gjera të nevojshme. Angazhim i vendosur për parimin se "themelet janë të parat" mbetet thelbësor që mundësia e zgjerimit të bëhet realitet. Mangësitë strukturore vazhdojnë, sidomos në fushat kyçe të sundimit të ligjit dhe të ekonomisë. Kandidatët e anëtarësimit duhet të arrijnë rezultate në sundimin e ligjit, reformën e drejtësisë, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në siguri, në të drejtat themelore, institucionet demokratike dhe në reformën e administratës publike, si dhe në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të reformave të nevojshme, ky është një proces afatgjatë.

Është e rëndësishme të pranojmë se negociatat e anëtarësimit nuk janë - dhe nuk kanë qenë kurrë - qëllim në vetvete. Ato janë pjesë e një **procesi më të gjerë modernizimi dhe reformimi**. Qeveritë e vendeve të zgjerimit duhet të angazhohen në reformat e nevojshme në mënyrë më aktive dhe t'i bëjnë pjesë të vërteta të agjendave të tyre politike - jo sepse këtë kërkon BE-ja, por sepse është në interesin më të mirë të qytetarëve të tyre. Angazhimi për vlerat themelore evropiane, si sundimi i ligjit, është thelbësor për zgjedhjen e gjeneratave që synojnë anëtarësimin në BE. Mbështetja publike për zgjerimet e ardhshme do të varet nga shkalla e gatishmërisë së vendeve candidate. Reformat e realizuara përmes procesit të anëtarësimit në BE duhet të kontribuojnë në rritjen e besimit të qytetarëve të shteteve anëtare të BE-së dhe të vendeve candidate.

Komisioni Evropian ripohoi perspektivën e fortë dhe të bazuar në merita të anëtarësimit në BE për **Ballkanin Perëndimor** në shkurtit të vitit 2018 në Komunikimin *Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor*¹. Ky është mesazh i fuqishëm inkurajimi për të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe shenjë e angazhimit të BE-së për të ardhmen e tyre evropiane. Udhëheqësit e vendeve të rajonit nuk duhet të lënë asnjë dyshim për orientimin dhe angazhimin e tyre strategjik. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë thelbësore për përparimin në shtigjet e tyre përkatëse evropiane. Komisioni Evropian gjithashtu deklaroi se Bashkimi ynë duhet të jetë më i fortë dhe më solid, para se të mund të jetë më i madh. Kjo është arsyeja pse gjatë këtij viti, në përputhje me Udhërrëfyesin për një Bashkim më të Bashkuar, më të Fortë dhe më Demokratik², Komisioni do të paraqesë një numër iniciativash që synojnë përmirësimin e kornizës demokratike, institucionale dhe politike për Bashkimin e vitit 2025, bazuar në Traktatet aktuale.

Turqia është partner kyç për BE-në dhe vend kandidat, me të cilin vazhdon dialogu në nivel të lartë dhe bashkëpunimi në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë mbështetjen për refugjatët sirianë. Komisioni njohu nevojën legjitime të Turqisë për të ndërmarrë veprime të shpejta dhe proporcionale përballë përpjekjes së dështuar të grushtit të shtetit të korrikut 2016. Sidoqoftë, Turqia është larguar ndjeshëm nga Bashkimi

¹ [COM\(2018\) 65 përfundimtar](#)

² https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/roadmap-factsheet-tallinn_en.pdf

Evropian, veçanërisht në fushat e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, si dhe përmes dobësimit të kontrolleve dhe balancave efektive në sistemin politik. Komisioni Evropian, në mënyrë të përsëritur i ka bërë thirrje Turqisë që t'i japë prioritet ndryshimit të kësaj prirjeje.

II. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ZGJERIMIN TË VITIT 2015

Trajtimi i reformave në fushën e **sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe qeverisjes së mirë** mbetet çështja më e ngutshme për vendet e zgjerimit. Këto përbëjnë një pikë kyçe referimi kundrejt së cilës BE-ja do të gjykojë për perspektivat e tyre. Vendet duhet t'i përqafojnë më fort këto vlera themelore të BE-së dhe në formë më të besueshme. Mosrespektimi i tyre është një tjetër pengesë për investimet dhe tregtinë. Forcimi i sundimit të ligjit nuk është thjesht çështje institucionale. Kjo kërkon transformim shoqëror.

a) Sundimi i ligjit

Përkundër përqendrimit në rritje në reformat e sundimit të ligjit, përparimi ka mbetur i pabarabartë në vendet e zgjerimit. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përkushtimi i fuqishëm i qeverisë së re për zbatimin e "Prioriteteve të Reformave Urgjente" ka pasur ndikim pozitiv në sundimin e ligjit. Në vazhdim të grushtit të shtetit të korrikut 2016, situata e sundimit të ligjit në Turqi vazhdoi të përkeqësohej.

Reformimi me sukses i **një sistemi gjyqësor** është proces afatgjatë që kërkon vullnet politik të qëndrueshëm nga i gjithë spektri politik, dhe vendet e zgjerimit i pret ende shumë punë. Në Shqipëri, procesi i paprecedent dhe në vazhdim i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve pritet të shërbejë si shtysë për sistemin gjyqësor në aspektin e profesionalizimit, pavarësisë dhe integritetit të tij. Në Turqi, shkarkimet masive të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ndryshimet kushtetuese kanë dëmtonuar më tej efikasitetin dhe pavarësinë e gjyqësorit.

Vendet duhet të çrrënjoshin pa kompromis **korrupsionin**, dhe të eliminojnë çdo element të kapjes së shtetit. Korrupsioni mbetet i përhapur, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për t'i përafuar kornizat ligjore dhe institucionale me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane. Institucionet e forta dhe të pavarura janë vendimtare për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, në veçanti në nivele të larta, dhe për të kryer hetime dhe ndjekje penale më efektive, duke çuar në vendime përfundimtare të gjykatave që zbatohen dhe që përfshijnë sanksione ndëshkuese. Kërkohet më shumë transparencë në menaxhimin e fondeve publike, sidomos në të gjitha fazat e prokurimit publik, një fushë veçanërisht e prirur për korrupsion.

Janë vendosur organet e specializuara, por rrallë hetohen rastet e pasurisë së pashpjegueshme në mesin e personave të ekspozuar politikisht. Përparimi i kufizuar tregon mungesën e vullnetit të mirë politik, çka kombinohet me kapacitetet ende të kufizuara administrative. Shtimi i transparencës dhe llogaridhënies, ndarja e kompetencave dhe forcimi i organeve mbikëqyrëse të pavarura mbeten thelbësore. Përpjekjet e nisura në Trieste në vitin 2017 për të rënë dakord për një instrument rajonal për shkëmbimin e të dhënave për shpalljen e pasurive dhe konflikteve të interesit mund të kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

Ndikimi i **krimit të organizuar** mbetet i fortë në vendet e zgjerimit. Grupet e fuqishme kriminale vazhdojnë të veprojnë në dhe nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe Turqia. Rajoni mbetet një rrugë e rëndësishme hyrjeje për trafikimin e mallrave të paligjshëm, në

veçanti drogës dhe armëve, si dhe të qenieve njerëzore në rrugën e tyre drejt BE-së. Vendet e zgjerimit po bashkëpunojnë gjithnjë e më shumë me agjencitë e zbatimit të ligjit të BE-së, si Europol dhe Eurojust, dhe po përmirësojnë gradualisht kapacitetin e tyre për të vepruar ndaj llojeve të veçanta të krimit të organizuar, përfshirë trafikun e drogës. Në Shqipëri, operacionet në shkallë të gjerë të zbatimit të ligjit çuan në konfiskime të suksesshme të sasive të mëdha të kanabisit, dhe kohët e fundit edhe të kokainës nga Amerika Latine. Sidoqoftë, problemet e personelit dhe respektimi i pavarësisë operacionale të organeve të zbatimit të ligjit mbeten problematike në rajon. Ka ende një hendek mes analizës së kërcënimeve të krimit të organizuar dhe prioriteteve të vendosura operacionale, duke ulur shkallën e suksesit në shkatërrimin efektiv të grupeve kriminale. Gjithashtu, autoritetet duhet të fillojnë përdorimin e hetimeve financiare, sipas metodologjisë së Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), dhe të përmirësojnë rezultatet në konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Në vendet e zgjerimit, themelimi dhe përforcimi i agjencive të centralizuara përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale (Zyrat e Rimëkëmbjes së Aseteve) mund t'i bëjnë më efektive sistemet e tyre kombëtare të rimëkëmbjes së aseteve dhe të lehtësojnë bashkëpunimin operacional me Zyrat e Rimëkëmbjes së Aseteve në shtetet anëtare të BE-së. Për parandalimin e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, vendet e zgjerimit duhet ta kenë prioritet përafrimin e legjislacionit dhe praktikave të tyre me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar. Është urgjentë që të ketë arritje konkrete dhe të qëndrueshme në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar.

Për të luftuar **terrorizmin**, ekstremizmin e dhunshëm, radikalizimin dhe veçanërisht fenomenin e (kthimit) të luftëtarëve të huaj terroristë, BE-ja ka rritur bashkëpunimin operacional me secilin nga vendet e zgjerimit. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme në të gjitha vendet për të harmonizuar legjislacionin dhe praktikën në fushën e anti-terrorizmit dhe luftës kundër radikalizimit, me standardet dhe praktikën e BE-së. Gjithsesi, ka ende hapësirë për struktura më efektive në nivel kombëtar dhe rajonal, në mënyrë që të sigurohen rezultate konkrete, veçanërisht në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, trafikimin e armëve, financimin e terrorizmit, pastrimin e parave, politikën e ndarjes së informacionit dhe anti-radikalizimin. Rrjeti BE-së për Vetëdijësim ndaj Radikalizimit ka mbështetur pjesën më të madhe të kësaj pune. Lufta kundër terrorizmit duhet të rritet më tej me secilin partner të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Standardet e mbrojtjes së të dhënave personale duhet të harmonizohen me standardet e BE-së, çka do të lejojë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Eurojust. Të frymëzuar nga puna e përbashkët e përbashkët kundër terrorizmit, BE-ja dhe partnerët nga Ballkani Perëndimor ranë dakord në vitin 2017 për Qeverisjen e Integruar të Sigurisë së Brendshme në Ballkanin Perëndimor, si një qasje e re për ndërtimin e kapaciteteve të qeverisjes së sigurisë dhe për reforma në rajon.

b) Të drejtat themelore

Të drejtat themelore janë kryesisht të sanksionuara në legjislacion në Ballkanin Perëndimor, por kërkohen përpjekje serioze për t'u siguruar që zbatohen plotësisht në praktikë. Turqia ka shfaqur një përkeqësim të vazhdueshëm e të fortë në fushat kyçe të të drejtave të njeriut gjatë periudhës raportuese.

Kërkohet fokus i veçantë për të mbrojtur **lirinë e shprehjes** dhe pavarësinë e mediave si shtyllë e demokracisë në të gjithë rajonin. Ka pasur një përkeqësim të rëndësishëm në këtë fushë në disa vende, duke përfshirë një kthim pas mjaft serioz në Turqi, ku mbi 150 gazetarë mbeten në burg. Në vendet e tjera ka pasur përparim të kufizuar, në rastin më të mirë. Kanë vazhduar sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, ndërsa hetimet dhe ndjekjet

penale mbeten të ngadalta. Përpyjekjet për të ndikuar në pavarësinë e transmetuesve të shërbimit publik dhe financimi jo transparent i mediave mbeten të përhapura në të gjitha vendet e zgjerimit. Këto abuzime dëmtojnë jo vetëm të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, por edhe demokracinë në rajon. Qeveritë duhet të ndërmarrin hapa urgjente dhe konkrete për të zbatuar kornizat ekzistuese ligjore për lirinë e shprehjes, si dhe për të përmirësuar klimën e përgjithshme të lirisë së mediave.

BE-ja mbështet fuqishëm organizatat lokale të shoqërisë civile, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, gazetarët dhe mediat e pavarura, të cilat shpesh bien pre e kërcënimeve. Kontributi i tyre është jetësor për të siguruar llogaridhënien e qeverisë për lirinë e shprehjes, si dhe për të gjitha të drejtat e tjera themelore.

Kërkohen përpjekje të shtuara në të gjitha vendet e zgjerimit për të trajtuar në mënyrë efektive abuzimet e të **drejtave të fëmijëve**, të cilat mbeten të përhapura. Gjithashtu, qeveritë duhet të adresojnë me prioritet diskriminimin ndaj **personave me aftësi të kufizuara, pakicave** dhe grupeve të tjera të cenueshme. Duhet të bëhet më shumë për të avancuar **barazinë gjinore** dhe për të parandaluar dhe adresuar dhunën ndaj grave. Teksa në Ballkanin Perëndimor është arritur përparim për të drejtat e personave lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe interseks, kërkohen përpjekje shtesë për t'i dhënë fund diskriminimit, kërcënimeve dhe dhunës. Edhe situata e pasigurtë e **romëve** duhet të jepet prioritet, pasi ata vazhdojnë të përballen me përjashtim social, marginalizim dhe diskriminim. **Kushtet e burgjeve** duhet të përmirësohen dhe të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar dhe të drejtave të viktimave duhet të përafrohen me *acquis-në* e BE-së. Në Turqi, dekretet e miratuara gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme kufizuan të drejtat kyçe procedurale, duke përfshirë të drejtat e mbrojtjes.

c) Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike

Funksionimi i duhur i **institucioneve demokratike** mbetet sfidë kyçe në një numër të vendeve. Kjo përfshin sigurimin e dialogut konstruktiv me të gjithë spektrin politik, posaçërisht në kuadër të **parlamenteve**. Pavarësisht një farë përparimi, disa aspekte themelore në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike ende janë sfiduese. Rekomandimet e misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve duhet të zbatohen siç duhet. Llogaridhënia parlamentare, si një element thelbësor i një demokracie funksionale, duhet të brumoset në kulturën politike.

Në Turqi, duke njohur nevojën legjitime të Turqisë për të ndërmarrë veprime të shpejta dhe proporcionale përballë përpjekjes së dështuar të grushtit të shtetit, ka shqetësime serioze në lidhje me proporcionalitetin e masave gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, e cila ende mbetet në fuqi dhe e ka kufizuar funksionin kyç legjislativ të parlamentit, ndërkohë që hapësira për dialog mes partive politike është ngushtuar më tej. Ndryshimet e thella kushtetuese, të cilat sipas Këshillit të Evropës nuk përmbajnë kontrollet dhe balancat e mjaftueshme dhe rrezikojnë ndarjen e pushteteve, u miratuan në një referendum të organizuar gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Në Ballkanin Perëndimor, kapaciteti i parlamenteve kombëtare për të ushtruar funksionin bazë legjislativ dhe mbikëqyrës është dëmtuar nga mungesa e dialogut politik, nga përdorimi i tepruar i procedurave urgjente parlamentare dhe nga mungesa e angazhimit konstruktiv nga të gjitha palët. Kultura politike përçarëse mbetet, edhe pse janë tejkaluar disa bojkote. Në Shqipëri, marrëveshja politike ndërpartiake e majit 2017 lejoi rifillimin e punimeve parlamentare përpara shkuarjes në zgjedhje. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, parlamenti i ri bëri përpjekje për të rivendosur kapacitetet e veta mbikëqyrëse mbi ekzekutivin. Sidoqoftë, në Malin e Zi, opozita ka bojkotuar veprimtarinë legjislativë

që nga mbledhja e parlamentit në nëntor 2016. Në Serbi, efektiviteti parlamentar dhe cilësia e legjislacionit vuajnë nga mungesa e shqyrtimit të duhur parlamentar të projektligjeve. Në Kosovë³, si në koalicionet e mëparshme ashtu edhe në atë aktual, puna e Kuvendit u shënua nga polarizimi politik dhe paraliza, edhe pse Kuvendi së fundmi ratifikoi Marrëveshjen e Demarkacionit të Kufirit me Malin e Zi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, miratimi i legjislacionit që rrjedh nga Agjenda e Reformës u ndikua negativisht nga tensionet mes partive të koalicionit qeverisës, duke çuar në një ngadalësim të procesit të reformave. Teksa në rajon zgjedhjet zhvillohen kryesisht pa incidente të mëdha, mangësitë e rëndësishme, duke përfshirë politizimin e organeve zgjedhore, abuzimin e burimeve shtetërore dhe mungesën e transparencës në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, ndikojnë në nivelin e besimit të qytetarëve në proceset zgjedhore.

Reforma e administratës publike është thelbësore për forcimin e qeverisjes në të gjitha nivelet. Kjo përfshin përmirësimin e cilësisë dhe llogaridhënies së administratës, rritjen e profesionalizmit, depolitizimin dhe transparencën, edhe në punësime dhe shkarkime, menaxhimin më transparent të financave publike dhe shërbime më të mira për qytetarët. Duhet gjithashtu të vendoset një ekuilibër i përshtatshëm mes qeverisjes qendrore, rajonale dhe lokale. Teksa ka pasur përparim të moderuar në disa fusha në Ballkanin Perëndimor, Turqia ka pësuar kthim serioz pas sa i përket menaxhimit të shërbimeve publike dhe burimeve njerëzore dhe llogaridhënies.

Tashmë janë vendosur **strategjitë gjithëpërfshirëse të reformave** të administratës publike dhe menaxhimit të financave publike, përveç në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Turqi. Shqetësim mbeten vonesat në zbatim dhe qëndrueshmëria financiare e reformave. Në shumë raste, transparenca buxhetore është përmirësuar. Cilësia e **planifikimit strategjik** të qeverisë qendrore dhe lidhjet me planifikimet sektoriale duhet të përmirësohen ndjeshëm në Ballkanin Perëndimor. Shpesh, politikat, legjislacioni dhe investimet publike ende përgatiten pa vlerësime sistematike të ndikimit dhe pa konsultime. Një problem kyç në shumicën e vendeve është përdorimi i gjerë i procedurave urgjente legjislative. **Profesionalizimi i shërbimit civil** ende duhet të sigurohet në të gjitha vendet. Përkundër legjislacionit modern të shërbimit civil, përjashtimet përdoren rregullisht, veçanërisht për emërimet dhe shkarkimet e nëpunësve të lartë civilë.

Në të gjitha vendet e zgjerimit, **struktura e administratës shtetërore** duhet të racionalizohet më tej. Në Ballkanin Perëndimor, organe të ngjashme administrative kanë staturë të ndryshme, me shumë prej tyre që raportojnë direkt në qeveri ose në parlament dhe jo në ministritë e tyre të linjës. Nuk ka llogaridhënie dhe raportim të mjaftueshëm mes agjencive të varura dhe institucioneve të tyre mëmë. Për të përmirësuar **ofrimin e shërbimeve**, shumica e vendeve të zgjerimit janë përqendruar në futjen e shërbimeve të qeverisjes elektronike, por iniciativat shpesh nuk kanë strategji drejtuese dhe koordinim. Shumica e vendeve kanë arritur përparim me miratimin e ligjeve moderne për procedurat e përgjithshme administrative, por në shumë vende duhet ende të ndryshohet një sasi e konsiderueshme e legjislacionit sektorial për të reduktuar në minimum procedurat e posaçme administrative.

d) **Migrimi**

Sfidat e lidhura me krizën e refugjatëve dhe **migracionin** e parregullt kanë qenë në qendër

³ Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/ 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

të punës së BE-së me vendet e zgjerimit. Është arritur përparim përmes punës së përbashkët përgjatë rrugëve migratore të Mesdheut Lindor/Ballkanit Perëndimor. Kontrabanda e migrantëve dhe trafikimi njerëzor mbeten shqetësues. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për t'u siguruar që vendet të jenë të pajisura më mirë për të përballuar sfidat e migracionit, duke përfshirë reduktimin e migracionit të parregullt, aktivitetet e kthimeve, mbrojtjen e kufijve dhe parandalimin e migracionit të parregullt, si dhe ngritjen e kapaciteteve për azil, përfshirje sociale dhe integrim, në përputhje me *acquis-në* e BE-së.

Me përpjekje të jashtëzakonshme, Turqia aktualisht siguron strehim për më shumë se 3.5 milionë refugjatë të regjistruar sirianë dhe BE-ja mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar Turqinë në adresimin e kësaj sfide. Bashkëpunimi sipas Deklaratës BE-Turqi ka vazhduar të japë rezultate konkrete. Është konsoliduar prirja e reduktimit të ndjeshëm të kalimeve të parregullta dhe të rrezikshme dhe e humbjes së jetëve në Detin Egje. 42 319 emigrantë kanë mbërritur përmes rrugës së Mesdheut Lindor gjatë vitit 2017, krahasuar me 182 277 në 2016, duke përfaqësuar një rënie prej pothuajse 77%. Rojet bregdetare turke mbetën të përkushtuara për patrullimin aktiv dhe parandalimin e kalimit të parregullt dhe hapjes së rrugëve të reja. Instrumenti i BE-së për Refugjatët në Turqi vazhdon të mbështesë nevojat e refugjatëve dhe të përkrahë komunitetet pritëse. Ndarja e parë e prej 3 miliardë eurosh është kontraktuar plotësisht. Deri tani, lëvrimet kanë arritur 1.9 miliardë euro. Ka filluar mobilizimi i ndarjes së dytë të Instrumentit, në përputhje me deklaratën BE-Turqi. Instrumenti ka dëshmuar të jetë një nga mekanizmat më të shpejtë dhe më të efektshëm të përkrahjes së BE-së, duke siguruar transfertat mujore të parave të gatshme për gati 1.2 milionë refugjatët më të cenueshëm, përmes Rrjetit të Sigurisë Sociale Emergjente. Më shumë se 312 000 fëmijë kanë marrë trajnim në gjuhën turke dhe ka filluar shpërndarja e artikujve mësimorë dhe librave për 500 000 studentë. Refugjatët kanë përfituar nga më shumë se 763 mijë konsultime për kujdesin parësor shëndetësor dhe më shumë se 217 mijë fëmijë refugjatë sirianë janë vaksinuar plotësisht.

Masat e përgjigjeve të koordinuara me BE-në në përkrahje të përpjekjeve kombëtare, kanë rezultuar në një reduktim prej 91% në rrjedhat e parregullta migratore që kalojnë përmes rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe një stabilizim të përgjithshëm të situatës përgjatë kufijve gjatë vitit 2017. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia në veçanti kanë dëshmuar se janë partnerë të besueshëm të BE-së në këtë fushë. Sidoqoftë, ato mbeten të prekura dhe aftësia e tyre për të përballuar situata krize është testuar vazhdimisht. Kapaciteti administrativ dhe infrastruktura kërkojnë forcim të mëtejshëm në të gjithë rajonin. BE-ja është e përkushtuar për përkrahjen e përpjekjeve të partnerëve të Ballkanit Perëndimor. Komisioni ka negociuar marrëveshjet e statusit mes Agjencisë së Kufijve Evropianë dhe Rojeve Bregdetare dhe Ballkanit Perëndimor. Këto do të lejojnë vendosjen e ekipeve të Agjencisë së Kufijve Evropianë dhe Rojeve Bregdetare me kompetenca ekzekutive në zonat në kufirin e jashtëm të BE-së, në mbështetje të autoriteteve kombëtare të kufirit.

e)

Ekonomia

Ballkani Perëndimor dhe Turqia kanë **potencial** domethënës **ekonomik**. Rritja e ritmeve të rritjes në vitet e fundit është përkthyer në krijimin e vendeve të punës në të gjithë sektorët. Pavarësisht përparimit, të gjitha qeveritë përballen me sfida të mëdha strukturore, ekonomike dhe sociale, me shkallë të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve, mospërputhje të mëdha të shkathtësive, nivele vazhdimisht të larta të ekonomisë informale, mjedise të dobëta biznesi me qasje të kufizuar në financa dhe nivele të ulëta të inovacionit rajonal. Në Ballkanin Perëndimor, klima e investimeve vazhdon të pengohet

nga shenjat e kapjes së shtetit, në veçanti sa i përket mungesës së sistemeve gjyqësore të pavarura dhe efikase dhe zbatimit të pabarabartë të rregullave të konkurrencës. Ndikimi i shtetit në ekonomi është i fortë në rajon, duke përkeqësuar rrezikun e korrupsionit përmes menaxhimit të dobët të financave publike dhe ndryshimeve të shpeshta në lejet dhe tatimet. Duhet të forcohet korniza e qeverisjes së korporatave dhe të finalizohet procesi i privatizimit. Duhet të përmirësohen sistemet e infrastrukturës dhe arsimit. Investimet e infrastrukturës në rajon duhet të jenë në përputhje me prioritetet e dakorduara me BE-në, veçanërisht në kontekstin e zgjerimit të Rrjeteve Trans-evropiane të Transportit në Ballkanin Perëndimor. Në Turqi rritja ekonomike u rimëkëmb me forcë, por mjedisi i biznesit vazhdoi të përkeqësohet dhe ekonomia mbetet e ndjeshme ndaj pasigurisë financiare, ndryshimeve në besimin e investitorëve globalë dhe rreziqeve të vazhdueshme politike.

BE-ja po mbështet përmirësimin e formulimit të politikave dhe qeverisjes ekonomike përmes ushtrimit të Programit të Reformave Ekonomike, i cili është pjesë integrale e procesit të përgatitjes. Ky ushtrim është bërë mjet kyç për formulimin dhe zbatimin e reformave makroekonomike dhe strukturore. Në këtë mënyrë, ndihmon për të forcuar rritjen e qëndrueshme afatgjatë dhe konvergjencën, lehtëson planifikimin e politikave dhe siguron përparim drejt kriterëve ekonomike të Kopenhagenit. Të gjitha qeveritë janë të ftuara të paraqesin programet vjetore të reformave ekonomike. Për të zbatuar reformat e identifikuar, tani kërkohet një shtytje e fortë politike dhe pronësi nga qeveritë e interesuara. BE-ja po mbështet edhe përmirësimin e klimës së investimeve në Ballkanin Perëndimor përmes thellimit të Zonës Ekonomike Rajonale që synon të heqë pengesat për tregtinë, mobilitetin dhe investimet në të gjithë rajonin. Në dhjetor 2016, Komisioni miratoi një rekomandim për hapjen e negociatave me qëllim të zgjerimit dhe modernizimit të mundshëm të Bashkimit Doganor BE-Turqi, i cili që nga ajo kohë është shqyrtuar në Këshill.

f) Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore

Bashkëpunimi rajonal është çelësi për të siguruar stabilizim politik dhe mundësi ekonomike. Agjenda e BE-së për lidhshmërinë i ka dhënë bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor një shtytje shtesë. Në vitin 2017, në Trieste, udhëheqësit e rajonit miratuan një plan veprimi për Zonën Ekonomike Rajonale dhe nënshkruan Traktatin e Komunitetit të Transportit. Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore dhe nisma të tjera rajonale gjithashtu kanë vazhduar të nxisin stabilizimin dhe bashkëpunimin. Është ngritur Zyra Rajonale e Bashkëpunimit për Rininë, e cila ka nisur thirrjen e parë për propozime për të vazhduar rritjen e bashkëpunimit njerëzor. Programi Erasmus + ka vazhduar të nxisë dialogun ndërkulturor në arsimin e lartë dhe në mesin e të rinjve dhe ka mbështetur veprime për të inkurajuar ndërkombëtarizimin dhe modernizimin e institucioneve dhe sistemeve të arsimit të lartë. Ka pasur disa përparime në realizimin e projekteve të lidhjes në terren. Strategjia e BE-së për Planin Rajonal të Veprimit të Zonës së Adriatikut dhe Jonit ka kontribuar në nxitjen e zhvillimit të projekteve të përbashkëta, duke nxitur harmonizimin e mëtejshëm me *acquis-në* në vendet pjesëmarrëse. Sidoqoftë, ende nuk janë përmbushur shumë detyrime nga marrëveshjet dhe angazhimet rajonale. Nëse duam që qytetarët të shohin përfitime reale nga bashkëpunimi rajonal, kërkohen më shumë përpjekje për t'i funksionalizuar këto marrëveshje dhe angazhime, duke përfshirë zbatimin e masave të reformës së lidhshmërisë të dakorduara në 2015.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë elemente thelbësore të Stabilizim-Asociimit dhe të proceseve të zgjerimit. Ndërkohë që ka pasur kontakte të

vazhdueshme dhe të rregullta mes qeverive, si dhe bashkëpunim në nivel dypalësh dhe rajonal, ka nevojë për më shumë përpjekje në fushat më të ndjeshme, siç janë krimet e luftës, personat e pagjetur, krimi i organizuar dhe bashkëpunimi gjyqësor dhe policor. Një përjashtim ka të bëjë me kthimin e refugjatëve nga luftërat ballkanike; këtu, Programi i Strehimit Rajonal po tregon rezultate pozitive. Duhet të shmangen deklaratat që ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore. Promovimi i stabilitetit dhe krijimi i një mjedisi të favorshëm për tejkalimin e trashëgimisë të së kaluarës dhe pajtim kërkojnë udhëheqje politike të përgjegjshme dhe përpjekje të mëtejshme thelbësore. Traktati i Miqësisë mes Bullgarisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është një shembull pozitiv në këtë drejtim.

Politika e zgjerimit të BE-së duhet të vazhdojë të eksportojë stabilitet. Prandaj BE-ja nuk mund dhe nuk do të importojë **mosmarrëveshje dypalëshe**. Ato duhet të zgjidhen si çështje urgjente nga palët përgjegjëse. Rezultatet në këtë drejtim kanë qenë të kufizuara. Kërkohej përpjekje të mëtejshme në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kërkohej përparim urgjent në dialogun e lehtësuar nga BE-ja drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, i cili duhet të rezultojë në arritjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme të normalizimit. Sa i përket ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duhet të shfrytëzohet përparimi pozitiv në drejtim të gjetjes së një zgjidhjeje të negociuar dhe reciprokisht të pranueshme për çështjen e emrit nën patronazhin e OKB, së bashku me përparimin e bërë në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Edhe Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra dypalëshe.

Ndonëse përpjekjet e përtërira të ndërmarra në bisedimet e kryesuara nga OKB-ja për zgjidhjen e çështjes së Qipros nuk arritën të japin një marrëveshje, është e rëndësishme të ruhet përparimi i bërë deri më tani dhe të vazhdohet me përgatitjet për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të realizueshme, duke përfshirë edhe aspektet e saj të jashtme. Përkushtimi i vazhdueshëm i Turqisë dhe kontributi në terma konkretë për negociatat për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të realizueshme të çështjes së Qipros në kuadër të OKB-së, do të jetë me rëndësi të madhe. Turqia duhet urgjentisht të përmbushë detyrimin e saj për zbatimin e plotë të Protokollit Shtesë dhe të bëjë përparim drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Komisioni kërkon shmangien e çdo lloj kërcënimi, burimi të fërkimit ose veprimeve që dëmtojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Komisioni thekson të gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së. Kjo përfshin, ndër të tjera, të drejtën për të lidhur marrëveshje dypalëshe dhe për të eksploruar dhe shfrytëzuar burimet natyrore në përputhje me *acquis-në* të BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit. Veprimet dhe deklaratat e Turqisë kundër disa shteteve anëtare të BE-së kanë krijuar tensione që po ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e saj me BE-në. Zgjidhja e këtyre çështjeve dypalëshe është një çështje prioritare.

III KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Bazuar në analizën e mësipërme dhe vlerësimet në përmbledhjet e vendeve në shtojcë, Komisioni paraqet **konkluzionet** dhe **rekomandimet** e mëposhtme:

I

1. Politika e zgjerimit të BE-së është një investim për **paqe, siguri, prosperitet, pra për stabilitet** në Evropë. Ajo ofron mundësi të shtuara ekonomike dhe tregtare për

përfitimin reciprok të BE-së dhe shteteve që aspirojnë anëtarësimin. Perspektiva e fortë e anëtarësimit në BE, e ripohuar vazhdimisht nga BE-ja dhe shtetet anëtare të saj, vazhdon të nxisë transformimin dhe të sigurojë stabilitet dhe siguri në vendet e Evropës Juglindore.

2. Procesi i zgjerimit vazhdon të ndërtohet mbi **kriteret e përcaktuara dhe kushtëzimin e drejtë dhe rigoroz**. Çdo vend vlerësohet në bazë të **meritave të veta**, në mënyrë që të sigurohen stimuj për të ndjekur reforma të thella. Angazhim i vendosur për parimin se "themelet janë të parat" mbetet thelbësor që mundësia e zgjerimit të bëhet realitet.
3. Strategjia e Komisionit për **Ballkanin Perëndimor**, e miratuar në shkurt 2018, ofron një **mundësi historike** për të lidhur në mënyrë të vendosur dhe pa mëdyshje të ardhmen e rajonit me Bashkimin Evropian. Tash, vendet e rajonit duhet të veprojnë me vendosmëri që të ecin përpara në mënyrë të vendosur dhe të pakthyeshme në procesin e transformimit, si dhe të adresojnë mangësitë ekzistuese, veçanërisht në lidhje me themelet e sundimit të ligjit, të drejtat themelore, institucionet demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe ekonomikisht.

II.

4. **Turqia** është partner kyç për Bashkimin Evropian. BE-ja, e cila menjëherë dhe fuqimisht dënoi grushtin e shtetit të korrikut 2016, përsëriti mbështetjen e saj të plotë për institucionet demokratike të vendit, si dhe njohu nevojën legjitime të Turqisë për të ndërmarrë veprime të shpejta dhe proporcionale përballë një kërcënimi të tillë të rëndë. Sidoqoftë, shkalla e gjerë dhe natyra kolektive e masave të ndërmarra që nga përpjekja e grushtit të shtetit, të tilla si pushimet nga puna, arrestimet dhe ndalimet e gjera, vazhdojnë të ngrenë shqetësime serioze në lidhje me proporcionalitetin e masave të gjendjes së jashtëzakonshme, e cila ende mbetet në fuqi. Qeveria turke përsëriti angazhimin e saj për anëtarësim në BE, por kjo nuk është mbështetur me masat dhe reformat korresponduese. Përkundrazi, Turqia është larguar dukshëm nga Bashkimi Evropian. Nën rrethanat aktuale, nuk konsiderohet hapja e asnjë kapitulli të ri. Turqia duhet të ketë prioritet kthimin e prirjes aktuale negative në sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore, duke filluar me heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe duke adresuar dobësimin e kontroleve dhe balancave efektive në sistemin politik, edhe përmes bashkëpunimit të përforcuar me Këshillin e Evropës.

Ka pasur kthim pas serioz në fushat kyçe të gjyqësorit, reformës së administratës publike, të drejtave themelore dhe lirisë së shprehjes, si dhe prapaktime të mëtejshme në një numër në rritje të fushave të tjera. Respekti i plotë i sundimit të ligjit dhe i të drejtave dhe lirive themelore është një detyrim thelbësor i procesit të anëtarësimit. Që nga vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, janë ndaluar mbi 150 mijë persona dhe janë arrestuar 78 mijë. Mbi 150 gazetarë mbeten në burg, së bashku me shumë shkrimtarë, mbrojtës të të drejtave të njeriut, avokatë dhe përfaqësues të zgjedhur. Shumë shtetas turq u arrestuan sepse kanë shprehur pikëpamjet e tyre politike në mediat sociale. Të 31 dekretet e nxjerra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat janë përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor dhe shqyrtimi efektiv nga ana e parlamentit, kanë kufizuar në thelb të drejtat kyçe civile dhe politike, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit dhe të drejtat e mbrojtjes. Formalisht, është funksionalizuar një Komision i Gjendjes së Jashtëzakonshme, por ende duhet të zhvillohet në një mjet efektiv dhe të besueshëm, në një kontekst ku kapaciteti i Turqisë për të siguruar një mjet efektiv juridik vendor, sipas kuptimit të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është dëmtuar më tej nga një numër vendimesh gjyqësore problematike.

Në referendumin e organizuar gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ndryshimet kushtetuese me ndikim të gjerë dhe që parashihnin një sistem presidencial, u miratuan me një diferencë të ngushtë. Sipas vlerësimit të Këshillit të Evropës, këto ndryshime nuk përmbajnë kontrole dhe balanca të mjaftueshme, si dhe rrezikojnë ndarjen e kompetencave mes ekzekutivit dhe gjyqësorit. Funkzioni kyç i parlamentit si ligjvënës është kufizuar, hapësira për dialog mes partive politike u ngushtua më tej në Parlament, teksa deputetë të tjerë të HDP u arrestuan dhe dhjetë prej tyre u zhveshën nga ulëset e tyre. Emërimi i të besuarve për të zëvendësuar përfaqësuesit e zgjedhur çoi në një dobësim të rëndësishëm të demokracisë lokale. Shoqëria civile u vu nën presion në rritje përballë një numri të madh të arrestimeve të aktivistëve, duke përfshirë edhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, çka ka çuar në ngushtimin e shpejtë të hapësirës për të drejtat dhe liritë themelore. Situata në juglindje mbetet një nga sfidat më kritike për stabilitetin e Turqisë. Nuk pati zhvillime në rifillimin e procesit të besueshëm politik që nevojitet për të arritur një zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme.

Teksa rritja u rimëkëmb fuqishëm në 2017, ajo mbetet e cenueshme nëse Turqia nuk adreson zbalancimet makroekonomike, nuk kryen reforma të mëtejshme strukturore dhe nuk përmirëson mjedisin e biznesit. Pasiguria politike, rritja e kontrollit shtetëror në sferën ekonomike dhe sulmet ndaj pavarësisë së gjyqësorit kanë çuar në një klimë investimi më pak të parashikueshme, një rënie në monedhën kombëtare dhe një rënie të ndjeshme në investimet e drejtpërdrejta evropiane.

BE-ja dhe Turqia vazhduan dialogun dhe bashkëpunimin e tyre në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë edhe një numër vizitash të nivelit të lartë dhe takime të liderëve në maj 2017 dhe mars 2018. Dialogu i nivelit të lartë vazhdoi në politikën e jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë masat kundër terrorizmit, në transport dhe në ekonomi. Komisioni Evropian nënvizon rëndësinë e propozimeve të tij në Këshill për zgjerimin dhe modernizimin e Bashkimit Doganor BE-Turqi, i cili do të ishte i dobishëm për të dyja palët.

Turqia vazhdoi të bënte përpjekje të jashtëzakonshme për të siguruar strehim për mbi 3.5 milionë refugjatë nga Siria dhe rreth 365 mijë refugjatë nga vendet e tjera. Bashkëpunimi me BE-në për migracionin ka vazhduar të japë rezultate konkrete dhe mbresëlënëse në reduktimin e kalimeve të parregullta dhe të rrezikshme, si dhe në shpëtimin e jetëve në Detin Egje. Instrumenti i BE-së për Refugjatët në Turqi vazhdon të mbështesë nevojat e refugjatëve dhe të përkrahë komunitetet pritëse. Sa i përket zbatimit të udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, në fillim të shkurtit Turqia i dorëzoi Komisionit Evropian një plan pune që përshkruan si planifikon Turqia të përmbushë shtatë standardet e liberalizimit të vizave. Komisioni po vlerëson propozimet e Turqisë dhe do të ketë konsultime të mëtejshme me homologët turq.

Turqia nisi një operacion ushtarak në Sirinë veriore. Teksa Turqia ka të drejtë të ndërmarrë veprime për të parandaluar sulmet terroriste kundër saj, operacioni ngriti shqetësime të menjëhershme humanitare, duke shtuar shqetësimet për një përshkallëzim të ri të dhunës.

Në përputhje me pozitat e përsëritura të Këshillit dhe Komisionit nga vitet e mëparshme, është urgjente që Turqia të përmbushë detyrimin e saj për zbatimin e

plotë të Protokollit Shtesë dhe të bëjë përparim drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Edhe pse Konferenca e mbledhur për Qipron u mbyll pa një marrëveshje në korrik 2017, është e rëndësishme të ruhet përparimi i arritur dhe të vazhdohet me përgatitjet për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke përfshirë edhe aspektet e saj të jashtme. Përkushtimi dhe kontributi i vazhdueshëm i Turqisë në terma konkretë për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të realizueshme do të jetë me rëndësi të madhe.

Është intensifikuar bashkëpunimi me Greqinë dhe Bullgarinë për migracionin. Sidoqoftë, tensionet në Detin Egje dhe Mesdheun Lindor nuk ishin të favorshme për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe dëmtuan stabilitetin dhe sigurinë rajonale. Marrëdhëniet dypalëshe me disa shtete anëtare të BE-së u përkeqësuan, duke përfshirë në disa raste edhe retorikë ofenduese dhe të papranueshme. BE-ja i bëri thirrje Turqisë të shmangë çdo lloj kërcënimi ose veprimi të drejtuar ndaj një shteti anëtar, ose çdo burim fërkimi ose veprimi që do të dëmtonte marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Për më tepër, në mars të vitit 2018, Këshilli Evropian dënoi ashpër veprimet e paligjshme të Turqisë në Mesdheun Lindor dhe Detin Egje dhe i rikujtoi Turqisë detyrimin për të respektuar ligjin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe për të normalizuar marrëdhëniet me të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

5. **Mali i Zi** mbajti zgjedhje presidenciale në prill 2018. U ndërmorën hapa fillestarë për të adresuar rekomandimet e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut pas zgjedhjeve parlamentare të 2016-ës. Sidoqoftë, përcjellja gjyqësore e parregullsive të raportuara ka qenë shumë e kufizuar. Kërkohej punë e mëtejshme për të konsoliduar besimin në kornizën zgjedhore. Kthimi i debatit politik në parlament është përgjegjësi e të gjitha palëve.

Negociatat e anëtarësimit në BE kanë përparuar më tej, me 30 kapituj të hapur, tre prej të cilëve janë mbyllur përkohësisht. Në fushën e sundimit të ligjit, Mali i Zi vazhdoi të bënte përparim në veçanti në kornizën ligjore dhe institucionale, ndërkohë që ndikimi praktik i reformave nuk është ende mjaft i dukshëm dhe nuk është bërë përparim në fushën e lirisë së shprehjes. I tërë sistemi i sundimit të ligjit, në veçanti gjyqësori, tani duhet të japë më shumë rezultate. Përparimi në kapitujt e sundimit të ligjit, i demonstruar nga rezultate të prekshme, në veçanti për forcimin e lirisë së shprehjes dhe të mediave, dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore, do të vazhdojë të përcaktojë ritmin e negociatave të anëtarësimit në përgjithësi.

Është bërë përparim i mirë në legjislacionin që synon zbatimin e rekrutimit të bazuar në meritë në të gjithë shërbimin publik, i cili tani duhet të zbatohet. Mali i Zi përparoi në forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe fiskal me fillimin e zbatimit të një strategjie afatmesme të konsolidimit fiskal. Niveli i borxhit publik është i lartë dhe vazhdon të rritet. Përpjekjet aktuale për të përmirësuar infrastrukturën dhe sistemin e arsimit duhet të plotësohen me reforma të tregut të punës, reduktim të faktorëve pengues për të punuar, dhe zhvillim të një industrie konkurruese të orientuara nga eksporti.

6. **Serbia** mbajti zgjedhje presidenciale në prill 2017. Pas dorëheqjes së Kryeministrit pas zgjedhjes së tij si President, qeveria e re mori detyrën në qershor 2017. Qeveria e re mbetet e angazhuar për integrimin në BE.

Negociatat e anëtarësimit në BE kanë përparuar, me 12 kapituj të hapur, dy prej të cilëve janë mbyllur përkohësisht. Ritmi i përgjithshëm i negociatave do të vazhdojë të varet nga përparimi i Serbisë në reforma, dhe në veçanti nga një ritëm më intensiv i reformave në sundimin e ligjit dhe në normalizimin e marrëdhënieve të saj me Kosovën. Ndërkohë që është arritur përparim në sundimin e ligjit, Serbia tani duhet të forcojë përpjekjet e saj dhe të japë më shumë rezultate, veçanërisht në drejtim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për lirinë e shprehjes, në forcimin e pavarësisë dhe efikasitetit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor, dhe në arritjen e përparimit të qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe pastrimin e parave. Reformat ekonomike vazhdojnë të japin rezultate, veçanërisht në aspektin e stabilitetit makroekonomik. Sidoqoftë, nivelet e investimeve publike dhe private mbeten të ulëta dhe duhet të përmirësohet më tej mjedisi i biznesit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Reformat e mëdha strukturore të administratës publike, autoritetit tatimor dhe ndërmarrjeve shtetërore mbeten të paplota. Në kontekstin e negociatave për anëtarësim, është thelbësore që Serbia të zhvillojë dhe të mbajë kapacitete më të mëdha administrative për t'u marrë me çështjet e BE-së.

Serbia duhet të thellojë ndjeshëm angazhimin e saj në Dialogun me Kosovën, duke përfshirë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve dhe në veçanti të marrëveshjes për Energjinë, Urën e Mitrovicës, MIK-un dhe Njohjen e Diplomave. Nisma e Presidentit për të nisur një dialog të brendshëm për Kosovën është e mirëpritur. Serbia duhet të vazhdojë të luajë rol pozitiv në rajon në përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe ruajtjen e stabilitetit.

7. **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**, pas një periudhe të vështirë më në fund e kapërceu krizën e saj të thellë politike, me mbështetjen e BE-së dhe ndërkombëtare. Vullneti politik për të ecur përpara është sërish i pranishëm dhe në mentalitetin politik në të gjithë shoqërinë është parë një ndryshim pozitiv, mungesa e të cilit ka qenë pengesë e madhe për reformat në vitet e fundit. Zbatimi i këtyre reformave të nevojshme strukturore është një proces afatgjatë.

Komisioni është i kënaqur që Marrëveshja e Pržino-s është zbatuar në masë të madhe, edhe pse në një kontekst të vështirë politik.

Është bërë punë e konsiderueshme për të adresuar Prioritetet e Reformave Urgjente që nga vera e vitit 2017, përmes një dëshire të vërtetë për reformë, e ndjekur nga përgatitja e strategjive dhe legjisllacionit të vonuar dhe konsultimi me të gjithë aktorët, përfshirë edhe opozitën, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. mes nëntorit 2017 dhe shkurtit 2018 u miratuan një numër i strategjive dhe ligjeve, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Shumë të tjerë po përgatiten për t'u miratuar në muajt e ardhshëm. Sidoqoftë, sfidat strukturore mbesin kryesisht në fushën e gjyqësorit.

Nën dritën e përparimit të arritur, Komisioni rekomandon që Këshilli të vendosë që të hapen negociatat e anëtarësimit me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, duke ruajtur dhe thelluar momentumin aktual të prioriteteve të reformave urgjente, vendimtare për përparimin e mëtejshëm të vendit. Për ta mbështetur këtë, Komisioni do të zbatojë qasjen e përforcuar për të negociuar kapitujt mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore, si dhe për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë në vend.

8. **Shqipëria** ka vazhduar të bëjë përparim të qëndrueshëm në zbatimin e pesë prioriteteve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. U konsolidua reforma e

administratës publike, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimin e saj. Janë ndërmarrë veprime të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore, veçanërisht përmes avancimit në zbatimin e një reforme gjithëpërfshirëse të drejtësisë. Kjo përfshin rezultatet e para të prekshme në rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingu), me dorëheqjen e 15 gjyqtarëve dhe prokurorëve të rangut të lartë, dhe proceset e para që rezultuan me shkarkimin e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese dhe konfirmimin në detyrë të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese.

U ndërmorën përpjekje të tjera të përcaktuara në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë luftën kundër trafikimit dhe kultivimit të drogës, duke dëshmuar arritje solide të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve. Janë miratuar masa shtesë për të përforcuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe personat që u përkasin pakicave dhe romët, dhe politikat kundër diskriminimit, si dhe për zbatimin e të drejtave pronësore.

Nën dritën e përparimit të arritur, Komisioni rekomandon që Këshilli të vendosë që të hapen negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, duke ruajtur dhe thelluar momentumin aktual të reformës në fushën kyçe të sundimit të ligjit, në veçanti në të gjitha pesë prioritetet kyçe, dhe duke vazhduar me rezultate konkrete dhe të prekshme në rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingu). Për ta mbështetur këtë, Komisioni do të zbatojë qasjen e përforcuar për të negociuar kapitujt mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore, si dhe për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë në vend.

9. **Bosnja dhe Hercegovina** ka vepruar me ritëm të ngadalshëm gjatë vitit 2017 në lidhje me prioritetet që rrjedhin nga procesi i reformave, veçanërisht në lidhje me agjendën e reformave. Duhet të rriten përpjekjet e reformave të orientuara nga BE-ja në mënyrë që të adresohen problemet strukturore të rrënjësura thellë që kanë penguar zhvillimin e vendit. Korniza zgjedhore duhet ende të ndryshohet urgjentisht, me synimin për të siguruar organizimin e duhur të zgjedhjeve të tetorit 2018 dhe zbatimin e qetë të rezultateve. Në këtë drejtim, të gjithë udhëheqësit politikë duhet të marrin përgjegjësinë e tyre dhe të gjejnë një zgjidhje në lidhje me Shtëpinë e Popujve të Federatës, në mënyrë që të mos dëmtojnë perspektivën e BE-së të vendit dhe të qytetarëve të tij. Reformat e mëtejshme socio-ekonomike, forcimi i sundimit të ligjit dhe i administratës publike në përputhje me standardet evropiane në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha niveleve, vazhdojnë të mbeten prioritet. Mekanizmi i koordinimit për çështjet e BE-së ka qenë efektiv në sigurimin e një sërë përgjigjesh të koordinuara të nevojshme për përgatitjen në vazhdim të Opinionit të Komisionit për aplikimin për anëtarësim në BE të Bosnjë dhe Hercegovinës. Funkionimi i duhur i këtij mekanizmi do të vazhdojë të mbetet thelbësor për të mundësuar që vendi të përballlet me sfidat në rritje të procesit të integritetit në BE, siç janë miratimi i strategjive të mëtejshme për të gjithë vendin dhe programi strategjik për përafrimin ligjor të vendit me *acquis-në* e BE-së. Zhvillimi ekonomik mbetet i ngadalhtë, duke vuajtur nga sundimi i dobët i ligjit, mjedisi ende i varfër i biznesit, administrata publike joefikase dhe e fragmentuar, pabarazitë e mëdha të tregut të punës, si dhe një klimë që nuk mbështet investimet.
10. Në **Kosovë**, reformat e lidhura me BE-në u ngadalësuan për shkak të një periudhe të gjatë zgjedhore në vitin 2017 dhe një konteksti politik të brendshëm sfidues, çka ndikoi në punën parlamentare. Aktorët politikë duhet të ri-angazhohen në një dialog

konstruktiv, me Kuvendin si forum kyç për debatin politik. Qeveria e re dhe Kuvendi duhet ta kenë prioritet përparimin e reformave dhe krijimin e konsensusit për çështjet kyçe strategjike për Kosovën. Duhet të përshpejtohen zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe i Agjendës Evropiane për Reforma. Ka pasur përparime në lidhje me ekonominë, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e mjedisit të biznesit. Sidoqoftë, duhet të ndërmerren masa kundër ekonomisë së përhapur informale dhe papunësisë së lartë. Situata në Kosovën veriore mbetet veçanërisht sfiduese. Ratifikimi i kohëve të fundit i marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi përbën një arritje të rëndësishme në frymën e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe është një hap vendimtar drejt liberalizimit të vizave. Komisioni po vlerëson arritjet e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Përpjekjet e 43 anëtarëve të Kuvendit të Kosovës në dhjetor 2017 për të shfuqizuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar kanë ngritur shqetësime serioze. Do të jetë thelbësore që Kosova të veprojë në përputhje të plotë me detyrimet e saja ndërkombëtare në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar, të cilat janë themeluar për të trajtuar disa pretendime për krime ndërkombëtare të kryera në kontekstin e konfliktit në Kosovë.

Kosova duhet të thellojë ndjeshëm angazhimin e saj në Dialogun me Serbinë, duke përfshirë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve dhe në veçanti të marrëveshjes për Asociacionin/Komunitetin e Komunave me shumicë serbe. Duhet të intensifikohet puna e Ekipit Menaxhues, e nisur më 4 prill, në përputhje të plotë me Marrëveshjet e Brukselit të viteve 2013 dhe 2015.

IV. SHTOJCA

1. Përmbledhjet e gjetjeve të raporteve³

2. Shtojcat statistikore

³ Referenca për numrin e dokumenteve të punës së stafit.



KOMISIONI
EVROPIAN

Strasbourg, 17.4.2018
COM(2018) 450 përfundimtar

SHTOJCAT 1 DHE 2

SHTOJCA

të

**KOMUNIKIMIT NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,
KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE
KOMISIONIN E RAJONEVE**

**Komunikimi i vitit 2018 për Politikën e Zgjerimit
të BE-së**

{SWD(2018) 150 përfundimtar} - {SWD(2018) 151 përfundimtar} -
{SWD(2018) 152 përfundimtar} -
{SWD(2018) 153 përfundimtar} - {SWD(2018) 154 përfundimtar} -
{SWD(2018) 155 përfundimtar} -
{SWD(2018) 156
përfundimtar}

Shtojca 1 - Përmbledhjet e gjetjeve të raporteve

Turqia

Gjendja e jashtëzakonshme e shpallur pas përpjekjes së grushtit të shtetit më 15 korrik 2016 mbetet në fuqi, duke synuar shpërbërjen e lëvizjes Gylen, e përcaktuar nga autoritetet turke si një organizatë terroriste përgjegjëse për përpjekjen e grushtit të shtetit, si dhe mbështetjen e luftës kundër terrorizmit, në sfondin e sulmeve të përsëritura në Turqi.

BE-ja, e cila menjëherë dhe fuqimisht dënoi grushtin e shtetit të, përsëriti mbështetjen e saj të plotë për institucionet demokratike të vendit, si dhe njohu nevojën legjitime të Turqisë për të ndërmarrë veprime të shpejta dhe proporcionale përballë një kërcënimi të tillë të rëndë. Sidoqoftë, shkalla e gjerë dhe natyra kolektive, si dhe disproporcionaliteti i masave të marra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme pas tentativës së grushtit të shtetit, siç janë shkarkimet, arrestimet dhe ndalimet e përhapura, vazhdojnë të ngrënë shqetësime serioze. Turqia duhet të heqë gjendjen e jashtëzakonshme pa vonësë.

31 dekretet e nxjerra deri tani gjatë gjendjes së jashtëzakonshme kanë mangësi serioze. Ato nuk i nënshtrohen një shqyrtimi të kujdesshëm dhe efektiv nga parlamenti. Rrjedhimisht, për një kohë të gjatë dekretet nuk kanë qenë të hapura për shqyrtimin gjyqësor dhe asnjë prej tyre ende nuk i është nënshtruar një vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Këto dekrete urgjente kanë kufizuar veçanërisht disa të drejta civile dhe politike, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit dhe të drejtat procedurale. Ato gjithashtu ndryshuan elementet kyçe të legjislacionit, të cilat do të vazhdojnë të kenë efekt kur të hiqet gjendja e jashtëzakonshme.

Që nga vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, janë ndaluar më shumë se 150 mijë persona, janë arrestuar 78 mijë dhe janë shkarkuar mbi 110 mijë nëpunës civilë, ndërsa sipas autoriteteve rreth 40 000 janë rilthyer në detyrë, nga të cilët rreth 3600 me dekret.

Është ngritur një Komisionit i Apelit i Gjendjes së jashtëzakonshme, i cila ka marrë gjithsej rreth 107 mijë kërkesa për apel. Ky Komision filloi të merrte vendime vetëm në dhjetor të vitit 2017 dhe deri më tani ka siguruar rivendosje vetëm për disa aplikantë. Vendimet e tij janë të hapura për shqyrtim gjyqësor. Ai duhet ende të zhvillohet në një mjet efektiv dhe transparent për ata të prekur padrejtësisht nga masat e gjendjes së jashtëzakonshme.

Përtej Komisionit të Apelit, kapaciteti i Turqisë për të siguruar një mjet juridik të brendshëm efektiv, sipas kuptimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është dëmtuar më tej nga një numër precedentësh të padëshirueshëm. Në një rast, një gjykatë më e ulët refuzoi të pranonte një vendim të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me një çështje emblematike; një vendim pasues nga Gjykata Kushtetuese për një të pandehur u pranua përfundimisht nga një gjykatë më e ulët. Disa vendime gjyqësore të favorshme për të pandehur të shquar, duke përfshirë Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut, u anuluan shpejt nga një gjykatë tjetër apo edhe nga e njëjta gjykatë, në disa raste pas komenteve nga ekzekutivi.

Rekomandimet kyçe të Këshillit të Evropës dhe organeve të tij ende nuk janë adresuar nga Turqia. Akuzat për keqburje duhet të provohen përmes procedurave transparente dhe në baza individuale. Përgjegjësia penale individuale mund të përcaktohet vetëm në respekt të plotë për ndarjen e pushteteve, pavarësinë e plotë të gjyqësorit dhe të drejtën e çdo individi për gjykim të drejtë. Turqia duhet të heqë gjendjen e jashtëzakonshme pa vonësë.

Në prill të vitit 2017, Turqia mbajti një referendum që miratoi me shumicë të ngushtë amendamentet kushtetuese që vendosin një sistem presidencial. Sipas vlerësimit të Komisionit të Venecias, këto ndryshime nuk përmbajnë kontrolle dhe balanca të mjaftueshme, si dhe rrezikojnë ndarjen e kompetencave mes ekzekutivit dhe gjyqësorit. Referendumi në vetvete ngriti shqetësime serioze në lidhje me ndikimin e përgjithshëm negativ të gjendjes së jashtëzakonshme, 'terrenin e pabarabartë' për të dy anët e fushatës, dhe dobësimin e masave mbrojtëse për integritetin e zgjedhjeve.

Nën gjendjen e jashtëzakonshme, u kufizua funksioni kyç i parlamentit si pushtet legjislativ, pasi qeveria vuri në përdorim dekretet emergjente me 'forcën e ligjit' për të rregulluar edhe çështjet që duhej të ishin përpunuar sipas procedurës së zakonshme legjislative. Nën dritën e përkeqësimit të fërkimeve politike në vend, hapësira për dialog mes partive politike u ngushtua më tej në Parlament. Pas heqjes së njëhershme të imuniteteve parlamentare në maj 2016, shumë ligjvënës të partisë opozitare HDP janë arrestuar dhe dhjetë prej tyre janë zhveshur nga ulëset e tyre.

U rrit roli i presidentit mbi ekzekutivin, pas disa transferimeve të pushteteve tek Presidenca përmes dekretive emergjente. Emërimi i të besuarve për të zëvendësuar zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e zgjedhur çoi në një dobësim të rëndësishëm të demokracisë lokale.

Shoqëria civile u vu nën presion në rritje përballë një numri të madh të arrestimeve të aktivistëve, duke përfshirë edhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, dhe përdorimit të përsëritur të ndalimit të demonstratave dhe llojeve të tjera të tubimeve, çka ka çuar në ngushtimin e shpejtë të hapësirës për të drejtat dhe liritë themelore. Shumë organizata të bazuara në të drejta mbetën të mbyllura si pjesë e masave të gjendjes së jashtëzakonshme, dhe nuk ka një mjet juridik efektiv në dispozicion në lidhje me konfiskimet.

Qeveria rishikoi kornizën ligjore që rregullonte marrëdhëniet civile-ushtarake, dhe rriti ndjeshëm kompetencat e ekzekutivit mbi ushtrinë, duke forcuar mbikëqyrjen civile. Si pjesë e ndryshimeve kushtetuese, u shfuqizuan gjykatat e larta ushtarake. Shërbimet ushtarake dhe të inteligjencës vazhdojnë të mos kenë llogaridhënie të mjaftueshme në Parlament.

Situata në juglindje ka vazhduar të jetë një nga sfidat më të mprehta për vendin. Gjendja e përkeqësuar e sigurisë është zhvendosur pjesërisht në zonat rurale. Zotimi i qeverisë për të vazhduar operacionet e sigurisë, në sfondin e akteve të dhunshme të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e cila mbetet në listën e BE-së të personave, grupeve dhe subjekteve të përfshira në aktet e terrorizmit, mbeti si një element përcaktues i situatës në rajon. Teksa qeveria ka një të drejtë legjitime për të luftuar kundër terrorizmit, ajo gjithashtu është përgjegjëse për të siguruar që kjo të bëhet në përputhje me sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Masat kundër terrorizmit duhet të jenë proporcionale. Plani i investimeve të qeverisë për rindërtimin e zonave të dëmtuara në juglindje ka rezultuar në ndërtimin e mijëra banesave, por vetëm pak persona të zhvendosur brenda vendit kanë marrë kompensim deri tani. Nuk pati zhvillime në rifillimin e procesit të besueshëm politik që nevojitet për të arritur një zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme.

Turqia është e përgatitur mesatarisht në fushën e reformës së **administratës publike**, me një angazhim të fortë për një administratë më të hapur dhe përdorimin e e-qeverisjes. Sidoqoftë, ka pasur një prapakthim serioz në fushën e menaxhimit të shërbimeve publike dhe të burimeve njerëzore dhe në fushën e llogaridhënies së administratës në lidhje me të drejtën për drejtësi administrative dhe të drejtën për të kërkuar kompensim. Ende duhet të sigurohet një mjet ligjor transparent dhe efektiv për shkarkimet në shkallë të gjerë.

Sistemi gjyqësor i Turqisë është në një fazë të hershme të përgatitjes. Vitin e kaluar ka pasur prapakthim serioz, veçanërisht në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Ndryshimet kushtetuese që rregullojnë Këshillin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (KGJP) hynë në fuqi dhe e dëmtuan më tej pavarësinë e tij nga ekzekutivi. KGJP-ja vazhdoi të angazhohej në pezullime dhe transferime në shkallë të gjerë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nuk është bërë asnjë përpjekje për të adresuar shqetësimet e lidhura me mungesën e kriterëve objektive, të bazuara në meritë, uniforme dhe të paracaktuara në rekrutimin dhe promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Vendi ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**, ku nuk është arritur ndonjë përparim. Korniza ligjore dhe institucionale ka nevojë për përafrim të mëtejshëm me standardet ndërkombëtare dhe vazhdon të lejojë ndikim të panevojshëm nga ana e ekzekutivit

në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë. Arritjet e Turqisë për hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin në rastet e korrupsionit mbetën të dobëta, veçanërisht në lidhje me rastet e korrupsionit në nivel të lartë. Nuk është arritur asnjë përparim në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës në punën e organeve publike. Kërkohej konsensus i gjerë politik ndërpartiak dhe vullnet i fortë politik për të luftuar me vendosmëri korrupsionin. Turqia duhet ende të ndjekë pothuajse të gjitha rekomandimet e Asamblesë së Këshillit të Evropës të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit. Korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Edhe perceptimi i korrupsionit mbetet i lartë.

Turqia ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes në **luftën kundër krimit të organizuar** dhe ka arritur disa përparime me miratimin e një strategjie të re dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Turqia duhet të përmirësojë legjislacionin e saj për krimin kibernetik, konfiskimin e aseteve dhe mbrojtjen e dëshmitarëve. Ekziston legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave, por nuk është ende në përputhje me standardet evropiane. Hetimet financiare mbeten të pakta. Rrallë zbatohet ngrirja e aseteve dhe niveli i aseteve të konfiskuara është i ulët. Në luftën kundër terrorizmit, ekziston një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për financimin e terrorizmit. Si legjislacioni penal ashtu dhe ai kundër terrorit duhet të përafrohen me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Parimi i proporcionalitetit duhet të respektohet në praktikë.

Turqia arriti përparim të mirë në fushën e **politikës së migracionit dhe azilit** dhe mbeti e përkushtuar për zbatimin e Deklaratës BE-Turqi të marsit 2016 për menaxhimin efektiv të flukseve migratore përgjatë rrugës së Mesdheut Lindor. Sa i përket zbatimit të udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, në fillim të shkurtit Turqia i dorëzoi Komisionit Evropian një plan pune që përshkruan si planifikon Turqia të përmbushë shtatë standardet e liberalizimit të vizave. Komisioni po vlerëson propozimet e Turqisë dhe do të ketë konsultime të mëtejshme me homologët turq.

Korniza ligjore turke përfshin garanci të përgjithshme për respektimin e të **drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore**, të cilat janë sfiduar dhe dobësuar nga një sërë dekretesh të emergjencës. Ka vazhduar prapaktimi serioz në **lirinë e shprehjes**, një fushë ku Turqia është në një fazë të hershme të përgatitjes. Me kalimin e kohës, veprimet e ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme janë shtrirë drejt zërave kritikë në media dhe botën akademikë ndër të tjera, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Lëndët penale kundër gazetarëve (më shumë se 150 prej tyre mbeten të ndaluar), mbrojtësve të të drejtave të njeriut, shkrimtarëve ose përdoruesve të mediave sociale, tërheqja e kartave të shtypit, si dhe mbyllja e shumë mediave ose emërimi nga qeveria i administruesve, janë shqetësime serioze dhe kryesisht bazohen në zbatimin selektiv dhe arbitrar të ligjit, veçanërisht në dispozitat për sigurinë kombëtare dhe luftën kundër terrorizmit. Ligji për Internetin dhe korniza e përgjithshme ligjor vazhdojnë t'i mundësojnë ekzekutivit të bllokojë përmbajtjen në internet pa urdhër të gjykatës dhe për një gamë tepër të gjerë të arsyeve. Ka pasur prapaktim serioz edhe në fushat e lirisë së tubimit, lirisë së shoqërimit, të drejtave procedurale dhe pronësore. Liria e tubimit vazhdon të jetë tepër e kufizuar, në ligj dhe në praktikë. Masat e miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme kanë shfuqizuar edhe masat mbrojtëse thelbësore për mbrojtjen e të ndaluarve nga abuzimet, duke rritur kështu rrezikun e mosndëshkimit, në një kontekst ku janë rritur akuzat për keqtrajtim dhe torturë. Dekretet e emergjencës vendosën kufizime shtesë për të drejtat procedurale, duke përfshirë të drejtat e mbrojtjes. Zbatimi i të drejtave pengohet nga fragmentimi dhe mandati i kufizuar i institucioneve publike përgjegjëse për të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe një kontekst dobësimi të pavarësisë së gjyqësorit. Varfëria ekstreme dhe mungesa e artikujve bazë mbeten të zakonshme në mesin e familjeve rome në Turqi. Të drejtat e grupeve më të cenueshme dhe të personave që u përkasin pakicave duhet të mbrohen mjaftueshëm. Dhuna me bazë gjinore, diskriminimi, gjuha e urrejtjes kundër pakicave, krimi i

urrejtjes dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të personave lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinerë dhe interseks janë ende një çështje shqetësuese serioze.

Turqia shprehu mbështetje për bisedimet për zgjidhjen e çështjes së Qipros mes krerëve të dy komuniteteve dhe për përpjekjet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Këshilltarit të tij Special. Konferenca për Qipron, e mbledhur në Gjenevë në janar 2017 dhe në Crans-Montana në korrik 2017, u mbyll pa marrëveshje. Turqia ende nuk ka përmbytur detyrimin e saj për të siguruar zbatimin e plotë dhe jodiskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit dhe nuk i ka hequr të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë kufizimet në lidhjet direkte të transportit me Qipron. Nuk pati përparim në normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe me Republikën e Qipros. Mbeten në fuqi konkluzionet për Turqinë të miratuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe të mbështetura nga Këshilli Evropian në dhjetor 2006. Ato përcaktojnë se negociatat nuk do të hapen në tetë kapituj⁴ që lidhen me kufizimet e Turqisë në raport me Republikën e Qipros dhe nuk do të mbyllet përkohësisht asnjë kapitull derisa Komisioni të konfirmojë që Turqia ka zbatuar plotësisht Protokollin Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit.

Është intensifikuar bashkëpunimi me Greqinë dhe Bullgarinë për migracionin. Sidoqoftë, tensionet në Detin Egje dhe Mesdheun Lindor nuk ishin të favorshme për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe dëmtuan stabilitetin dhe sigurinë rajonale. Marrëdhëniet dypalëshe me disa shtete anëtare të BE-së u përkeqësuan, duke përfshirë në disa raste edhe retorikë ofenduese dhe të papranueshme. Në mars

2018, Këshilli Evropian dënoi ashpër veprimet e paligjshme të Turqisë në Mesdheun Lindor dhe Detin Egje dhe i rikujtoi Turqisë detyrimin për të respektuar ligjin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe për të normalizuar marrëdhëniet me të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Këshilli Evropian gjithashtu shprehu shqetësimin e tij të madh lidhur me ndalimin e vazhdueshëm të shtetasve të BE-së në Turqi, duke përfshirë dy ushtarë grekë, dhe bëri thirrje për zgjidhjen e shpejtë dhe pozitive të këtyre çështjeve përmes dialogut me shtetet anëtare.

Turqia duhet të angazhohet pa mëdyshje për marrëdhëniet e mira fqinjësore, marrëveshjet ndërkombëtare dhe për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në përrputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke u mbështetur, nëse është e nevojshme, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këtë kontekst, BE-ja ka shprehur edhe njëherë shqetësim serioz dhe i kërkoi Turqisë të shmangë çdo lloj kërcënimi ose veprimi të drejtuar kundër një shteti anëtar, ose çdo burim fërkimesh ose veprimesh që dëmtojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, ekonomia turke është mjaft e avancuar dhe mund të konsiderohet një ekonomi tregu funksionale. Ekonomia, e mbështetur nga masat stimuluese të qeverisë, arriti të rimëkëmbet nga tkurrja e dëshmuar pas përpjekjes së grushtit të shtetit të vitit 2016, dhe arriti një rritje të fortë gjatë vitit 2017. Sidoqoftë, rritja e lartë shoqërohet me pabarazi të rëndësishme makroekonomike. Deficiti aktual i llogarisë mbetet i lartë dhe u rrit në fund të vitit 2017, duke e bërë vendin të varur nga flukset hyrëse të kapitalit dhe të cenueshëm nga goditjet e jashtme. Inflacioni u rrit në nivele dyshifrore (11.1%) në vitin 2017, dhe vazhdoi zhvlerësimi i lirisë turke, duke theksuar shqetësimet për shkallën e angazhimit të vendimmarrësve të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve. Ekonomia e Turqisë vazhdoi të karakterizohej nga një nivel i lartë informaliteti. Në përgjithësi, ka pasur prapaktim në këtë fushë. Tendanca për të rritur kontrollin e shtetit në sferën ekonomike dhe veprimet që shënjestrojnë kompanitë, biznesmenët dhe kundërshtarët politikë dhe bizneset e tyre dëmtuan mjedisin e biznesit.

⁴ Lëvizja e lirë e mallrave, e drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime, shërbime financiare, bujqësi dhe zhvillim rural, peshkim, politika të transportit, bashkimi doganor dhe marrëdhëniet e jashtme.

Turqia ka arritur disa përparime dhe ka niveu të mirë të përgatitjes për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Turqia është e integruar mirë me tregun e BE-së në drejtim të tregtisë dhe investimeve. U arritën disa përparime në sektorin e energjisë, veçanërisht në tregun e gazit dhe në rritjen e shpenzimeve të kërkimit dhe zhvillimit. Sidoqoftë, mbeten probleme të konsiderueshme në lidhje me cilësinë e arsimit. Nuk pati përparim në përmirësimin e transparencës së ndihmës shtetërore.

Sa i përket **aftësisë së vendit për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, Turqia ka vazhduar të përafrohet me *acquis-në*, megjithëse me një ritëm të kufizuar. Ka pasur më shumë raste të prapaktimit në një numër të aspekteve kyçe në fushat e shoqërisë së informacionit, politikës sociale dhe punësimit, si dhe të marrëdhënieve të jashtme. Turqia është mjaft e avancuar në fushat e së drejtës së kompanive, rrjeteve trans-evropiane dhe shkencës dhe hulumtimit, dhe ka arritur një nivel të mirë të përgatitjes në fushat e lëvizjes së lirë të mallrave, të së drejtës së pronësisë intelektuale, shërbimeve financiare, ndërmarrësisë dhe politikës industriale, mbrojtjes shëndetësore, bashkimit doganor dhe kontrollit financiar. Turqia është e përgatitur mesatarisht në prokurimin publik, pasi mbeten hendekë të rëndësishme në përafrimin e saj. Turqia është gjithashtu e përgatitur mesatarisht në fushën e statistikave dhe politikave të transportit, ku kërkohen përpjekje të mëtejshme të rëndësishme në të gjithë sektorët. Turqia ka arritur një nivel të përgatitjes për mjedisin dhe ndryshimet klimatike, por politikat më ambicioze dhe më të koordinuara duhet ende të vendosen dhe të zbatohen. Në të gjitha fushat, duhet kushtuar më shumë vëmendje për të zbatuar legjislacionin, ndërsa shumë fusha kërkojnë përparim të mëtejshëm të rëndësishëm për të arritur harmonizimin legjislativ me *acquis-në* e BE-së.

Mali i Zi

Sa i përket **kritereve politike**, periudha e raportimit është shënuar nga niveli i ulët i besimit ndaj kornizës zgjedhore dhe nga bojkoti i zgjatur parlamentar nga e gjithë opozita, që nga zgjedhjet parlamentare të tetorit 2016. Kthimi i debatit politik në Parlament është përgjegjësi e të gjithë aktorëve politikë. Një pjesë e opozitës u kthye në parlament në dhjetor 2017, por ky përfundim i pjesshëm dhe selektiv i bojkotit duhet ende të rezultojë në përmirësimin e dialogut dhe shqyrtimit parlamentar. Skena politike mbetet e fragmentuar, e polarizuar dhe e shënuar nga mungesa e dialogut politik, sidomos në institucionet demokratike.

Kapaciteti legjislativ parlamentar dhe mbikëqyrja e ekzekutivit duhet të rriten më tej. Parlamenti ende i adreson në mënyrë të kufizuar gjetjet e auditimit të Institucionit Shtetëror të Auditimit dhe nuk ka diskutim apo raportim për zbatimin e politikave dhe legjislacionit kyç. Në dhjetor 2017, Parlamenti miratoi pa konsultim të duhur publik një sërë ligjesh që i adresojnë vetëm pjesërisht rekomandimet e Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Duhet të konsiderohet një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore. Gjatë periudhës raportuese ka pasur 8 zgjedhje lokale. Zgjedhjet lokale nuk të zhvillohen në të njëjtën ditë në mbarë vendin, por në baza rrotulluese; kështu që peisazhi politik karakterizohet nga një atmosferë e zgjatur dhe shumë e personalizuar zgjedhore. Për shkak të ciklit zgjedhor, vëzhgimi i zgjedhjeve është i vështirë, veçanërisht për vëzhguesit ndërkombëtarë, duke lënë hapësirë të mjaftueshme për pretendime për parregullsi që nuk mund të vlerësohen në mënyrë të pavarur. Nuk pati zhvillime të reja në përcjelljen politike dhe gjyqësore të keqpërdorimit të supozuar të fondeve publike për qëllime të partive politike në vitin 2012 ("aferat e regjistrimeve audio").

Sa i përket qeverisjes, ekziston nevoja për të forcuar transparencën, pjesëmarrjen e aktorëve dhe aftësinë e qeverisë për të zbatuar reformat. Duhet të sigurohet koherenca e sistemit të krijimit të politikave përmes zhvillimit të politikave të bashkërenduara. Ekzistojnë mekanizmat

për konsultimin qeveritar të organizatave të shoqërisë civile, por ato kanë nevojë për rregulla të qarta dhe përfshirje të sinqertë nga të dyja palët.

Mali i Zi është i përgatitur mesatarisht me reformën e **administratës** së tij **publike**. Është arritur përparim i mirë, sidomos përmes miratimit të ligjeve të reja për nëpunësit civilë, punonjësit shtetërorë dhe për vetëqeverisjen lokale, që kanë për qëllim zbatimin e rekrutimit të bazuar në meritë në të gjithë shërbimin publik. Ende kërkohet vullnet i fortë politik për të adresuar në mënyrë efektive depolitizimin e shërbimit publik dhe optimizimin e administratës shtetërore, si dhe për të siguruar zbatimin efikas dhe qëndrueshmërinë financiare të reformave.

Sistemi gjyqësor i Malit të Zi është i përgatitur mesatarisht dhe ka bërë përparim. Korniza legjislative e gjyqësorit që synon të rrisë pavarësinë dhe profesionalizmin e saj ende duhet të zbatohet plotësisht. Kapaciteti institucional është forcuar.

Mali i Zi ka arritur një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Pavarësisht nga disa përparime, korrupsioni është mbizotërues në shumë fusha dhe mbetet çështje shqetësuese. Është përmirësuar kapaciteti operacional i institucioneve; megjithatë, të gjitha institucionet duhet të demonstrojnë një qëndrim më proaktiv. Duhet të adresohen sfidat për besueshmërinë, pavarësinë dhe përcaktimin e prioritetëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Mbeten për t'u përmirësuar hetimet financiare dhe sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve. Është themeluar një regjistër fillestar i hetimit, ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, por duhet të konsolidohet më tej. Përmirësimet e mëtejshme të arritjeve të hetimeve dhe dënimeve të suksesshme do të jenë të mundshme vetëm në një mjedis ku institucionet e pavarura mbrohen nga çdo ndikim i panevojshëm dhe nxiten t'i përdorin plotësisht kompetencat e tyre.

Në **luftën kundër krimit të organizuar**, ka arritje fillestare të ndjekjeve penale në luftën kundër kontrabandës së migrantëve dhe kundër trafikut të drogës. Sidoqoftë, kërkohen rezultate të mëtejshme për të prodhuar arritje bindëse, veçanërisht në luftën kundër pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Për **të drejtat themelore**, Mali i Zi e përafroi më tej legjislacionin e vet me standardet e BE-së. Në veçanti, është përmirësuar puna e zyrës së Avokatit të Popullit, por kërkohen ende përpjekje për forcimin e kornizës institucionale dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Pas përparimit të arritur në legjislacionin kundër diskriminimit, Mali i Zi tani duhet të sigurohet që janë vendosur mekanizmat adekuate institucionale për të mbrojtur grupet e cenueshme nga diskriminimi. Zbatimi i legjislacionit mbetet i dobët dhe duhet të rriten kapacitetet institucionale për të drejtat e njeriut. Pakica romë⁵ mbetet komuniteti më i cenueshëm dhe më i diskriminuar. Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj fëmijëve mbetet një shqetësim serioz në vend.

Mali i Zi ka arritur një nivel të përgatitjes për **lirinë e shprehjes**, por nuk është bërë përparim në periudhën raportuese. Nuk ka pasur zhvillime të dukshme në lidhje me hetimet në rastet e vjetra të dhunës kundër gazetarëve. Ndërhyrja politike e kohëve të fundit në Këshillin Kombëtar të Transmetuesit Publik dhe Agjencinë për Mediat Elektronike janë një çështje shqetësuese dhe serioze. Skena e mediave mbetet shumë e polarizuar dhe vazhdojnë sfidat për të kuptuar rolin e mediave të lira. Numri i rasteve të shpifjes mbetet i lartë, gjithashtu për shkak të mekanizmave të dobët vetë-rregullues.

Mali i Zi mbeti i angazhuar në mënyrë konstruktive për marrëdhëniet dypalëshe me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare të BE-së fqinje, si dhe pjesëmarrës aktiv në **bashkëpunimin rajonal**.

⁵ Të gjitha këto grupe janë konsideruar nën termin më të gjerë "romë" të kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritit të Romëve.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Mali i Zi ka bërë njëfarë përparimi dhe është i përgatitur mesatarisht në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. U forcua stabiliteti makroekonomik dhe fiskal, por kërkohen përpjekje të mëtejshme për të adresuar sfidat e vazhdueshme, veçanërisht barrën e lartë të borxhit publik. Ekonomia po rritet në mënyrë të pandërprerë që nga viti 2013, me inflacion të ulët ose të moderuar. Sektori financiar ka përmirësuar aftësinë paguese dhe likuiditetin e vet. Sidoqoftë, baza e eksportit duhet të përmirësohet në fushëveprim dhe cilësi për të ulur deficitin tregtar. Dobësitë në sundimin e ligjit, duke përfshirë konkurrencën e pandershme nga ekonomia informale, ndikojnë negativisht në mjedisin e biznesit. Tregu i punës përballet me sfida strukturore, të pasqyruara në pjesëmarrje të ulët dhe shkallë të lartë të papunësisë.

Mali i Zi ka arritur disa përparime dhe është mesatarisht i përgatitur sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Ndërtimi i infrastrukturës kyçe në një numër fushash si dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor përcaktojnë bazën për përmirësimin e konkurrencës. Reforma në arsim është në vazhdim, por kërkohen më shumë përpjekje për të adresuar mospërputhjen e shkathtësive. NVM-të ende ballafaquar me sfida të shumta, të tilla si qasja në financa ose kompleksiteti rregullator. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar ecurinë e përgjithshme të eksporteve të kompanive lokale.

Lidhur me **aftësinë** e Malit të Zi **për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, është bërë punë e rëndësishme në përafrimin dhe përgatitjen për zbatimin e *acquis*-së në shumicën e fushave. Vendi ka një nivel të mirë të përgatitjes në fusha të tilla si ligji i kompanive dhe politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes. Ai është i përgatitur mesatarisht në shumë kapituj, si lëvizja e lirë e mallrave, bujqësia, siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare. Mali i Zi është në fazën e hershme të përgatitjes në lidhje me peshkimin dhe dispozitat buxhetore dhe financiare, dhe në njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, statistikave, politikave sociale dhe punësimit. Është arritur përparim i mirë në fushat e ligjit të kompanive, bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, politikës veterinare dhe fitosanitare. Ka pasur një kthim prapa në fushën e prokurimit publik. Duke parë përpara, Mali i Zi duhet të përqendrohet në veçanti në politikën e konkurrencës, mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe prokurimin publik. Forcimi i kapaciteteve administrative për të siguruar zbatimin e *acquis*-së mbetet një sfidë e konsiderueshme për Malin e Zi. Mali i Zi ka vazhduar të përafrohet me të gjitha pozicionet dhe deklaratat e përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Edhe pse Mali i Zi deri më sot ka mbetur jashtë rrugës kryesore të **migrimit** nga Ballkani Perëndimor drejt BE-së, vendi ka dëshmuar një rritje të numrit të emigrantëve/azilkërkuesve që hyjnë në territorin e tij, dhe prandaj duhet të forcojë kapacitetin për t'u përballur me rritjen e papritur të presionit të lidhur me migracionin. Mali i Zi ka bërë përparim të mëtejshëm në veçanti në kornizën ligjore të lidhur me migracionin. Teksa kapaciteti i Malit të Zi për të trajtuar kërkesat për azil ka qenë i mjaftueshëm deri tani, mund të sfidohet nga: (i) numri në rritje i azilkërkuesve dhe kohëzgjatja e qëndrimeve të tyre, ndonjëherë për shkak të procedurave të gjata të apelit; dhe (ii) vendosja e procedurave më kërkuese për azil, në përputhje me standardet e BE-së. Në këtë kontekst, Mali i Zi duhet të vendosë një mekanizëm kthimi për migrantët e parregullt, në përputhje me *acquis*-në e BE-së, si dhe të harmonizojë politikën e vet të vizave në mënyrë progresive me BE-në. Mali i Zi duhet të hapë objekte plotësuese pritëse që plotësojnë standardet e kërkuara dhe të përmirësojë menaxhimin e të gjitha objekteve. Më tej, pas miratimit të planit të veprimit Shengen në shkurt 2017, Mali i Zi vazhdoi të harmonizojë legjislacionin e vet me *acquis*-në e BE-së për vizat.

Serbia

Sa i përket **kritereve politike**, Serbia zhvilloi zgjedhjet presidenciale në prill 2017. Vëzhguesit ndërkombëtarë konstatuan se zgjedhjet u dhanë votuesve një zgjedhje të mirëfilltë të garuesve, por se terreni u ndikua nga disa faktorë. Rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtarë duhet të adresohen plotësisht, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me transparencën dhe integritetin e procesit zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore.

Pas dorëheqjes së Kryeministrit Vuçiç pas zgjedhjes së tij si President, qeveria e re, e kryesuar nga Ana Brnabiç, mori detyrën në qershor 2017. Për herë të parë, një grua u zgjodh Kryeministre. Parlamenti ende nuk ushtron mbikëqyrje efektive të ekzekutivit. Duhet të rriten transparenca, përfshirja dhe cilësia e hartimit të ligjeve, si dhe të përmirësohet dialogu ndërpartiak. Duhet të reduktohet përdorimi i procedurave urgjente. Duhet të shmangen veprimet që kufizojnë aftësinë e parlamentit për një shqyrtim efektiv të legjislacionit. Duhet të pranohet plotësisht roli i organeve të pavarura rregullatore. Kërkohen reforma kushtetuese për përafrimin me standardet e BE-së në disa fusha.

Serbia është mesatarisht e përgatitur në fushën e **reformës së administratës publike**. Janë arritur disa përparim në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe me miratimin e disa ligjeve të reja. Serbia duhet të zbatojë objektivat e saj të reformës, të profesionalizojë dhe depolitizojë administratën, veçanërisht në lidhje me pozitat e larta drejtuese, dhe të sigurojë koordinim dhe monitorim sistematik të programit të reformës së menaxhimit financiar 2016-20. Aftësia e Serbisë për të tërhequr dhe mbajtur në administratë staf të kualifikuar që merren me çështjet e BE-së, do të jetë vendimtare.

Sistemi gjyqësor i Serbisë ka një nivel të përgatitjes. Janë bërë disa përparime, sidomos duke zvogëluar numrin e lëndëve të vjetra të zbatimit dhe duke vendosur masa për harmonizimin e praktikës gjyqësore. Janë miratuar rregulla të përmirësuara për vlerësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ushtrimi i ndikimit politik mbi gjyqësorin mbetet shqetësues. Një draft i ri i amendamenteve të Kushtetutës në fushën e gjyqësorit u botua në janar të vitit 2018, dhe u prezantua për diskutim publik para se të dërgohej në Komisionin e Venecias për mendimin e tij.

Serbia ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Ka pasur disa përparime, veçanërisht me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal në seksionin e krimeve ekonomike; në ligjin për organizimin e autoriteteve shtetërore në fushën e luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit; dhe në ligjin për sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Sidoqoftë, ka një vonesë serioze në miratimin e ligjit të ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Kapaciteti operacional i institucioneve relevante mbetet i pabarabartë. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë ende duhet të vërtetojnë se mund të hetojnë, ndjekin penalisht dhe të gjykojnë të gjitha rastet e korrupsionit në nivel të lartë në një mënyrë të paanshme të pavarur.

Serbia ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër krimit të organizuar**. Ka pasur disa përparime në fusha si menaxhimi i burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendshme dhe polici. Është përmirësuar kapaciteti operacional i Prokurorisë për Krimin e Organizuar dhe i Prokurorisë për Krimin Kibernetik. U miratua një strategji dhe plan veprimi i ri për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, u emërua Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe u miratua Ligji i ri për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Sidoqoftë, Serbia ende nuk ka shënuar arritje fillestare të hetimeve financiare efektive, si dhe të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e pastrimit të parave. Numri i dënimeve për krimin e organizuar mbetet i ulët. Serbia duhet të përqendrohet në zbatimin e planit të veprimit të rënë dakord me Task Forcën e Veprimit Financiar.

Korniza ligjore dhe institucionale për respektimin e **të drejtave themelore** është në fuqi. Duhet të sigurohet zbatimi konsekuent në të gjithë vendin, duke përfshirë mbrojtjen e pakicave. Derisa Serbia ka një nivel të përgatitjes, nuk është bërë përparim në **lirinë e shprehjes**, një çështje që përbën shqetësim në rritje. Kërkohen përpjekje të mëtejshme e të vazhdueshme për të përmirësuar situatën e personave që u përjasin grupeve më të diskriminuara (romë, lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinjorë dhe interseks, persona me aftësi të kufizuara, persona me HIV/AIDS dhe grupe të tjera të cenueshme sociale). Duhet të miratohet një ligj për barazinë gjinore.

Serbia në tërësi ka mbetur e angazhuar në mënyrë konstruktive për marrëdhëniet dypalëshe me vendet e tjera të zgjerimit dhe vendet fqinje të BE-së, si dhe pjesëmarrëse aktiv në **bashkëpunimin rajonal**.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën**, Serbia ka mbetur e angazhuar në dialog. Sidoqoftë, Serbia duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme substanciale për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese, si dhe të kontribuojë në krijimin e rrethanave që favorizojnë normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Kosovën, që do të përcaktohen në një marrëveshje ligjërish të detyrueshme.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Serbia ka bërë përparim të mirë dhe është mesatarisht e përgatitur në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Janë adresuar disa nga dobësitë e politikave, veçanërisht në lidhje me deficitin buxhetor. Bazat e rritjes janë të shëndosha dhe është ruajtur stabiliteti makroekonomik. Inflacioni u përmbajt dhe politika monetare mbështeti rritjen. Kushtet e tregut të punës u përmirësuan më tej. Sidoqoftë, borxhi qeveritar, megjithëse i reduktuar, është ende i lartë dhe duhet të forcohen korniza buxhetore dhe qeverisja e saj. Reformat e mëdha strukturore të administratës publike, autoritetit tatimor dhe ndërmarrjeve shtetërore mbeten të paplota. Punësimi informal, papunësia dhe pasiviteti ekonomik mbeten ende shumë të larta, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë. Sektori privat është i pazhvilluar dhe pengohet nga dobësitë në sundimin e ligjit dhe në zbatimin e konkurrencës së ndershme.

Serbia është e përgatitur mesatarisht për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. Janë bërë disa përparime për të rritur konkurrueshmërinë. Sidoqoftë, niveli i aktivitetit të investimeve është ende nën nevojat e ekonomisë. Pavarësisht disa përmirësimeve, kompanitë përballen me një sërë vështirësish, duke përfshirë mjedisin sfidues të biznesit, nivelin e lartë të tarifave para-fiskale dhe asjen e vështirë dhe të kushtueshëm në financa.

Sa i përket **aftësisë së saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, Serbia ka vazhduar të harmonizojë të gjithë legjislacionin e saj me *acquis-në* e BE-së. Burimet e mjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe korniza të shëndosha strategjike do të jenë vendimtare për ruajtjen e ritmit të reformave. Serbia ka një nivel të mirë të përgatitjes në fusha të tilla si ligji i kompanive, prona intelektuale, shkenca dhe hulumtimi, arsimit dhe kultura, dhe doganat. Serbia përmirësoi lidhjen e planifikimit të saj të investimeve me ekzekutimin e buxhetit, por ende nuk ka zhvilluar një mekanizëm të vetëm për prioritizimin e të gjitha investimeve pavarësisht nga burimi i financimit, në përputhje me programin e qeverisë për reformën e menaxhimit të financave publike. Në fusha të tilla si prokurimi publik, statistikat, politika monetare dhe kontrolli financiar, Serbia është e përgatitur mesatarisht. Serbia duhet të harmonizojë në mënyrë progresive politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian në periudhën deri në anëtarësim. Serbia duhet të trajtojë, si çështje prioritare, çështjet e mospërputhjes me MSA-në, veçanërisht lidhur me kufizimet ndaj lëvizjeve të kapitalit, rregullimin e ndihmës shtetërore, diskriminimin fiskal mbi pijet e importuara alkoolike dhe kufizimet në eksportet e mbeturinave.

Serbia vazhdoi të menaxhojë efektet e **krizës së migrimit dhe refugjatëve**. Serbia është në proces të negociatave me BE-në për marrëveshjen e statusit për veprimet që duhet të ndërmerren nga Agjencia e Kufijve Evropiane dhe Rojet Bregdetare në Serbi. Serbia miratoi një ligj të ri për azilin dhe mbrojtjen e përkohshme, një ligj për të huajt dhe një ligj për kontrollin e kufirit. Duhet të miratohet një strategji dhe një plan veprimi për periudhën 2017-2020 për të luftuar migracionin e parregullt. Në këtë kontekst, Serbia duhet të vendosë një mekanizëm të fuqishëm të kthimit për migrantët e parregullt, në përputhje me *acquis-në* e BE-së, si dhe të harmonizojë politikën e vet të vizave në mënyrë progresive me BE-në. Duhet të sigurohet një koordinim më i fortë mes autoriteteve të ndryshme shtetërore të përfshira në menaxhimin e migracionit. Serbia vazhdoi të bashkëpunojë me vendet fqinje dhe shtetet anëtare, në veçanti në nivel teknik, dhe bëri përpjekje të konsiderueshme për të ofruar strehim dhe furnizime humanitare, kryesisht me mbështetjen e BE-së. Serbia duhet të rrisë kapacitetin e saj për të trajtuar nevojat e veçanta të pritjes për të miturit e pashoqëruar.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Lidhur me **kriteret politike**, vendi më në fund ka kapërcyer krizën më të rëndë politike që nga viti 2001. Procesi i vështirë i formimit të qeverisë arriti një pikë kritike gjatë sulmit të 27 prillit 2017 në Parlament, i cili u dënua në terma më të forta nga bashkësia ndërkombëtare. Që nga maji 2017, Qeveria e re - e orientuar nga reformat - ka ndërmarrë hapa për të adresuar kapjen e shtetit duke rivendosur gradualisht kontrollin dhe balancat, duke forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit. Vendi po kalon ndryshime thelbësore në një atmosferë më gjithëpërfshirëse dhe të hapur. Zgjedhjet komunale në tetor 2017 konfirmuan mbështetjen e qytetarëve për politikën e orientuar nga BE-ja të koalicionit qeveritar. Parlamenti ka vazhduar të funksionojë me partitë e opozitës që kryesojnë komitetet kyçe. Parlamenti duhet të përmirësojë funksionet e veta të mbikëqyrjes dhe legjislativës, duke përfshirë kufizimin e përdorimit të gjerë të procedurave të shkurtuara.

Teksa situata ndëretnike ishte e brishtë, situata mbeti e qetë në përgjithësi. Shqyrtimi i zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të vitit 2001 dhe siguron kornizën për marrëdhëniet ndëretnike, duhet të ndiqet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Qeveria ka treguar përkushtim për të rritur besimin mes komuniteteve.

Shoqëria civile vazhdoi të luajë rol konstruktiv në mbështetjen e proceseve demokratike dhe sigurimin e kontroleve dhe balancave më të mëdha. Që nga gjysma e dytë e vitit 2017, është përmirësuar klima në të cilën funksionojnë organizatat e shoqërisë civile dhe qeveria ka treguar përkushtim ndaj dialogut dhe përfshirjes.

Vendi është i përgatitur mesatarisht me reformën e **administratës së tij publike**. Është arritur përparim i mirë me miratimin e strategjisë së reformës së administratës publike dhe programit të reformës së menaxhimit të financave publike. Janë bërë përpjekje konkrete për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm në hartimin e politikave. Duhet të përmirësohet kapaciteti i Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës për të drejtuar dhe koordinuar reformën e administratës publike. Përkushtimi i fuqishëm politik për të garantuar profesionalizmin e administratës publike, sidomos në emërimet e menaxhmentit të lartë dhe respektimin e parimeve të transparencës, meritës dhe përfaqësimit të barabartë në përputhje me frymën dhe dispozitat e ligjit, mbetet thelbësor.

Sistemi **gjqësor** i vendit ka arritur një nivel të përgatitjes dhe është bërë përparim i mirë, sidomos në pjesën e dytë të periudhës raportuese. Prapaktimi i viteve të mëparshme ka filluar të përmbysset përmes hapave vendimtare të ndërmarra gjatë muajve të fundit, veçanërisht për të filluar rivendosjen e pavarësisë së gjyqësorit. Vendi miratoi një strategji të re të besueshme për reformën gjyqësore, e cila përbën bazën për reforma të mëtejshme në këtë fushë, dhe janë ndryshuar pjesët kyçe të legjislativës në përputhje me rekomandimet e Komisionit të

Venecias dhe "Prioritetet e Reformave Urgjente". Prokuroria Speciale përballet me më pak pengesa nga gjykatat, duke i lejuar të punojë në mënyrë më efektive. Adresimi i rekomandimeve të mbetura dhe sigurimi se gjyqësori mund të funksionojë pa ndikim të panevojshëm, do të kërkojnë përpjekje të qëndrueshme.

Sa i përket **luftës kundër korrupsionit**, vendi ka arritur një nivel të përgatitjes. Është krijuar korniza legjislative dhe institucionale, si dhe ka arritur në parandalimin dhe ndjekjen penale, edhe pse vendimet përfundimtare të gjykatave për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë mbeten të kufizuara. Korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Kapaciteti i institucioneve për të trajtuar në mënyrë efektive korrupsionin ka treguar mangësi strukturore dhe operacionale. Ndërhyrja politike mbetet një rrezik.

Në **luftën kundër krimit të organizuar**, vendi ka arritur një nivel të përgatitjes. Korniza legjislative është kryesisht në përputhje me standardet evropiane dhe duhet të vazhdojë përpjekjet për të zbatuar strategjitë. Vendi ka ndërmarrë hapa drejt reformimit të sistemit të përgjimit të komunikimeve dhe për adresimin e "Prioriteteve të Reformave Urgjente". Duhet bërë më shumë për të luftuar në mënyrë efektive forma të caktuara të krimit, si pastrimi i parave dhe krimet financiare. Koordinimi mes të gjithë palëve relevante të interesit është thelbësor. Duhet të përmirësohen arritjet në hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet në luftën kundër krimit të organizuar. Numri i dënimeve mbetet i ulët.

Korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e **të drejtave themelore** është kryesisht e vendosur dhe reformat kanë rritur pajtueshmërinë me standardet evropiane të të drejtave të njeriut. Zbatimi i plotë kërkon përpjekje të qëndrueshme. Është pozitive që vendi ratifikoi Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (e njohur edhe si Konventa e Stambollit), nisi reformat e nevojshme ligjore për krijimin e një mekanizmi të mbikëqyrjes së jashtme të autoriteteve të zbatimit të ligjit, dhe që ndryshimet në kornizën për mosdiskriminim u përgatitën në mënyrë gjithëpërfshirëse. Duhet të adresohet situata në burgje dhe institucione psikiatrike, duhet të përcillen rastet e krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe duhet të forcohen organet e përfshira në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Kërkohen më shumë përpjekje sa i përket përfshirjes së **romëve**. Sa i përket **lirisë së shprehjes**, vendi ka arritur një nivel të përgatitjes dhe ka bërë përparim të mirë, sidomos përmes një klime të përmirësuar për median dhe zvogëlimit të presionit ndaj gazetarëve. Vendi duhet të trajtojë sfidat e mbetura, duke përfshirë reformën e transmetuesit publik.

Sa i përket **bashkëpunimit rajonal**, vendi mbajti marrëdhëniet e mira me vendet e tjera të zgjerimit dhe mori pjesë aktive në iniciativat rajonale. Janë ndërmarrë hapa vendimtarë për të përmirësuar marrëdhëniet e mira fqinjësore, duke përfshirë hyrjen në fuqi të traktatit dypalësh me Bullgarinë. "Çështja e emrit" duhet të zgjidhet si çështje urgjente. Bisedimet për "çështjen e emrit" janë intensifikuar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Diskutimet konstruktive në nivelet e Kryeministrave dhe Ministrave të Jashtëm vlerësuan pozitivisht përparimin në zbatimin e masave të ndërtimit të besimit. Njoftimi i përbashkët i Kryeministrave të Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në janar 2018, duke përfshirë riemërtimin e aeroportit të Shkupit dhe një autostrade, dhe vazhdimi i disa iniciativave të vonuara të BE-së, ishin shenja konkrete për forcimin e besimit reciprok.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë njëfarë përparimi dhe është në një nivel të mirë të përgatitjes në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Pavarësisht ngërçit politik në gjysmën e parë të vitit, u bënë përmirësime të rëndësishme, në veçanti në menaxhimin e financave publike dhe transparencën. Dobësitë kyçe të ekonomisë mbeten. Këto përfshijnë mangësi në mjedisin e biznesit, siç janë zbatimi i dobët i kontratave dhe një ekonomi e madhe informale. Problemet strukturore të tregut të punës pasqyrohen në aktivitet të ulët dhe shkallë të lartë të papunësisë. Mjedijsi makroekonomik u

përkeqësua në gjysmën e parë të vitit 2017, pasi kriza e gjatë politike ndikoi negativisht në investimet. Politika fiskale është e orientuar drejt masave afatshkurtra, dhe mungon një plan i qëndrueshëm konsolidimi.

Ekonomia ka arritur disa përparime dhe është mesatarisht e përgatitur për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Përparim i mëtejshëm është bërë drejt diversifikimit të eksporteve dhe prodhimit më të lartë me vlerë të shtuar në sektorin e prodhimit. Marrëdhëniet e tregtisë dhe investimeve me BE-në vazhduan të intensifikohen. Ekonomia ende vuan nga dobësitë në kurrikulat e arsimit, normat e ulëta të inovacionit dhe hendekët e rëndësishëm të investimeve, duke përfshirë në veçanti infrastrukturën publike.

Sa i përket aftësisë **të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**, vendi është mesatarisht i përgatitur në shumicën e fushave, duke përfshirë në fushat e konkurrencës, transportit dhe energjisë. Vendi tregon një nivel të mirë të përgatitjes në fusha të tilla si ligji i kompanive, bashkimi doganor, rrjetet trans-evropiane dhe shkenca dhe hulumtimi. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në të gjitha fushat, veçanërisht në ato pak fusha ku vendi është në një fazë të hershme të përgatitjes, si liria e lëvizjes së punëtorëve. Po ashtu, kërkohet më shumë fokus për kapacitetet administrative dhe zbatimin efektiv. Vendi ka vazhduar të përmirësojë përafrimin me deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdoi të menaxhojë efektet e **krizës së migrimit dhe refugjatëve**. Vend është në proces të negociatave me Bashkimin Evropian për marrëveshjen e statusit për veprimet që duhet të ndërmerren nga Agjencia e Kufijve Evropianë dhe Rojet Bregdetare në vend. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë përpjekje për të përmirësuar kornizën e saj ligjore. Puna për ndryshimin e Ligjit për të Huajt është në vazhdim. Vendi vazhdoi të zbatojë Rezolutën e tij për Politikën e Migracionit. Vendi i vazhdoi përpjekjet për të përmirësuar sistemin e azilit dhe menaxhimin e migracionit. Kërkohet ende regjistrimi sistematik i migrantëve dhe profilizimi i ndjeshëm ndaj mbrojtjes, për të garantuar trajtimin e nevojave të këtyre individëve. Në këtë kontekst, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet të krijojë një mekanizëm kthimi për emigrantët e parregullt, që është në përputhje me *acquis-në* e BE-së, si dhe të harmonizojë politikën e vet të vizave në mënyrë progresive me BE-në. Vendi vazhdoi të bashkëpunojë me vendet fqinje dhe shtetet anëtare, në veçanti në nivelin teknik, dhe bëri përpjekje të konsiderueshme për të ofruar strehim dhe furnizime humanitare, kryesisht me mbështetjen e BE-së.

Shqipëria

Sa i përket **kritereve politike**, ka vazhduar polarizimi i fortë politik. Aktivitetet parlamentare u prekën nga një bojkot i zgjatur nga ana e opozitës në fillim të vitit 2017, çka vonoi edhe emërimin e institucioneve të vettingut gjyqësor. Në maj, një marrëveshje mes partisë kryesore qeverisëse dhe opozitës lejoi rinisjen e aktiviteteve parlamentare, duke shkaktuar disa ndryshime në kuadrin legjislativ zgjedhor. Kjo ishte e favorshme për organizimin e qetë të zgjedhjeve të përgjithshme në qershor, megjithëse një numër i rekomandimeve të Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ende mbeten të pazgjidhura. Është bërë përparim në drejtim të përmirësimit të funksionimit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Kërkohen përpjekje shtesë për përfshirjen më të mirë të organizatave të shoqërisë civile, si pjesë e një dialogu gjithëpërfshirës të politikave.

Shqipëria është i përgatitur mesatarisht me reformën e **administratës së saj publike**. Përpjekjet kanë vazhduar, duke sjellë disa përparime në efikasitetin dhe transparencën e ofrimit të shërbimeve publike, trajnimin e nëpunësve civilë, procedurat më transparente të rekrutimit dhe forcimin e përgjithshëm të procedurave të bazuar në merita të shërbimit civil.

Konsolidimi i këtyre arritjeve duhet të përparojë më tej, për të siguruar një administratë publike më efikase, të depolitizuar dhe profesionale.

Sistemi gjyqësor i Shqipërisë ka një nivel të përgatitjes. Ka vazhduar zbatimin e reformës së thellë dhe gjithëpërfshirëse të drejtësisë, duke rezultuar në përparim të mirë në përgjithësi. Ka filluar ri-vlerësimi i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vettingut) dhe po jep rezultatet e para të prekshme. Ky proces ka përkrahje ndërpartiake, kryhet nga një autoritet i pavarur, i nënshtrohet monitorimit ndërkombëtar dhe përputhshmëria e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut është konfirmuar nga Komisioni i Venecias. Nën suazat e Komisionit Evropian, është vendosur një Operacion Monitorimi Ndërkombëtar për të mbikëqyrur procesin gjatë zbatimit të tij. Institucionet ndihmëse që mbështesin procesin kanë përfunduar raportet e tyre të para mbi vlerësimet e aftësisë, kontrollet e historikut dhe deklaratat e pasurisë.

Shqipëria ka ruajtur një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Është arritur përparim i mirë, sidomos me miratimin e amendamenteve të kodit të procedurës penale. Po krijohet një zinxhir i organeve të specializuara anti-korrupsion, duke përfshirë një zyrë të posaçme prokuroriale. Krahasuar me periudhën e mëparshme raportuese, është rritur numri i dënimeve përfundimtare që përfshijnë zyrtarë të ulët apo të mesëm. Dënimet e zyrtarëve të nivelit të lartë kanë ndodhur kryesisht në gjyqësor (gjyqtarë dhe prokurorë); megjithatë, shkalla e dënimeve përfundimtare për zyrtarët e lartë mbetet në përgjithësi shumë e ulët. Korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz.

Shqipëria ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër krimit të organizuar**. Në përgjithësi, pati përparim gjatë periudhës raportuese, sidomos në luftën kundër kultivimit të kanabisit. Shqipëria duhet të mbështetet në rezultatet operacionale në këtë fushë, duke intensifikuar konfiskimin e pasurive që u përkasin bandave kriminale dhe duke ndjekur shkatërrimin e të gjitha magazinave ekzistuese të kanabisit. Ndryshimet në ligjin anti-mafia dhe Kodin e Procedurës Penale kanë krijuar kushtet për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale. Shqipëria ka marrë pjesë me sukses në bashkëpunimin ndërkombëtar policor, duke intensifikuar ndërveprimet veçanërisht me vendet anëtare të BE-së. Në nivel vendi, duhet ende të përmirësohet bashkëpunimi efektiv mes policisë dhe prokurorisë. Sa i përket arritjeve, ka pasur pak përparim në çmontimin e grupeve kriminale të organizuara. Numri i dënimeve përfundimtare në rastet e krimit të organizuar ka mbetur shumë i ulët, dhe është rritur vetëm pak. Kërkohen më shumë përpjekje për të trajtuar **pastrimin e parave**, asetet kriminale dhe pasuritë e pajustificuara.

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare për **të drejtat e njeriut** dhe ka zhvilluar kuadrin ligjor në përputhje me standardet evropiane. Ende duhet të forcohet zbatimimi dhe monitorimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sa i përket **lirisë së shprehjes**, Shqipëria ka një nivel të përgatitjes/është mesatarisht e përgatitur. Ka pasur disa përparime në forcimin e pavarësisë së autoritetit rregullator dhe transmetuesit publik, por duhet ende të rritet transparenca e reklamave shtetërore në media. Ende kërkohet përparim në fushën e të drejtave pronësore, me përditësimin e legjislacionit aktual dhe përforcimin e koordinimit institucional. Mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave e fëmijës dhe për trajtimin e dhunës me bazë gjinore mbeten të dobëta. Hapa të rëndësishëm u bënë për të përmirësuar kuadrin ligjor për respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve, por duhet të zhvillohet legjislacioni përkatës dytësor. Duhet të përmirësohen kushtet e jetesës për romët dhe egjiptianët.

Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktive në **bashkëpunimin rajonal** dhe të mbajë marrëdhënie të mira fqinjësore. Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për të adresuar çështjet bilaterale me Greqinë.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria ka bërë disa përparime dhe është mesatarisht e përgatitur në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së dhe deficitit aktual i llogarisë janë zvogëluar. Rritja ekonomike u rrit më tej, dhe papunësia është zvogëluar, por mbetet e lartë. Janë zvogëluar kreditë me probleme në sektorin bankar, por kreditimi bankar ndaj bizneseve mbetet i ngathët. Reformat thelbësore për përmirësimin e mjedisit të biznesit kanë pasur përparim, por kërkohen përpjekje të mëtejshme, duke përfshirë zvogëlimin e ekonomisë informale. Reforma gjithëpërfshirëse gjyqësore kanë përparuar, por duhet të zbatohen plotësisht. Ligji i ri i falimentimit ka hyrë në fuqi dhe duhet të forcojë regjimin e falimentimit. Sidoqoftë, rregulloret relevante për biznesin mbetën të rënda dhe mangësitë në sundimin e ligjit vazhduan të pengonin bizneset dhe investimet.

Shqipëria ka arritur disa përparime dhe ka një nivel të përgatitjes sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Në mënyrë të veçantë, u arrit përparim në infrastrukturën e energjisë dhe transportit dhe digjitalizimin, edhe pse mbeten mangësi që pengojnë konkurrueshmërinë dhe tregtinë e Shqipërisë. Cilësia e arsimit duhet të rritet në të gjitha nivelet, për t'i pajisur më mirë njerëzit me aftësitë e kërkuara nga tregu i punës. Tregtia e jashtme mbetet nën potencial dhe e koncentruar në sektorë. Kapaciteti i Shqipërisë për kërkime, zhvillim dhe inovacion mbetet i ulët.

Shqipëria vazhdoi të harmonizojë legjislacionin e saj me kërkesat e BE-së në një numër fushash, duke rritur **aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit**. Vendi është mesatarisht i përgatitur në shumë fusha, të tilla si kontrolli financiar, arsimi dhe kultura, ose ka një nivel të përgatitjes, duke përfshirë fushat e prokurimit publik dhe statistikave. Shqipëria do të duhet të vazhdojë përpjekjet e saja sa i përket përgatitjeve të përgjithshme për miratimin dhe zbatimin e *acquis-së* të BE-së. Duhet të vazhdojë puna për zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë, gjithashtu me qëllim përmirësimin e lidhshmërisë në të gjithë rajonin. Duhet të forcohen kapacitetet administrative dhe standardet profesionale të organeve që do të ngarkoheshin me zbatimin e *acquis-së* dhe të ruhet pavarësia e organeve rregullatore. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, në veçanti duke siguruar funksionimin efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike, mbetet thelbësore. Shqipëria ka vazhduar të përafrohet plotësisht me të gjitha pozicionet dhe deklaratat e përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Numri i aplikimeve të pabazuara për azil të paraqitura nga shtetasit shqiptarë në vendet anëtare të BE-së dhe në shtetet e Shengenit ka mbetur i lartë. Shqipëria tregoi përkushtim dhe miratoi një numër masash, duke përfshirë forcimin e bashkëpunimit dypalësh me shtetet anëtare të BE-së. Këto masa dhanë rezultate pozitive. Duhet të vazhdohet me veprime të mëtejshme vendimtare, duke përfshirë në kuadër të mekanizmit të monitorimit pas liberalizimit të vizave, për ta trajtuar këtë fenomen në mënyrë efektive. Shqipëria duhet të krijojë një mekanizëm kthimi për migrantët e parregullt, në përputhje me *acquis-në* e BE-së, si dhe të harmonizojë politikën e vet të vizave në mënyrë progresive me BE-në.

Bosnja dhe Hercegovina

Sa i përket **kritereve politike**, mbetet të ndryshohet urgjentisht korniza zgjedhore, me synimin për të siguruar organizimin e duhur të zgjedhjeve të tetorit 2018 dhe zbatimin e qetë të rezultateve. Në këtë drejtim, të gjithë udhëheqësit politikë duhet të marrin përgjegjësinë e tyre dhe të gjejnë një zgjidhje në lidhje me Shtëpinë e Popujve të Federatës. Ende nuk është zbatuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2010 për respektimin e së drejtës demokratike themelore të qytetarëve të Mostarit për të votuar në zgjedhjet lokale. Miratimi i legjislacionit që rrjedh nga Agjenda e Reformës, përfshirë miratimin e legjislacionit të akcizës, u ndikua negativisht nga tensionet mes partive të koalicionit qeverisës dhe pengesat nga partitë e opozitës në parlamentet, në nivel shtetëror dhe të njëjësive, çka çoi në një ngadalësim të ritmit të reformës. Agjenda e Reformës është zbatuar në mënyrë efektive kur niveli i shtetit dhe nivelet e njëjësive

kanë bashkëpunuar në mënyrë të koordinuar. Kushtetuta e Bosnjë dhe Hercegovinës mbetet në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas rastit *Sejdić-Finci* dhe rasteve të lidhura.

Funksionimi i Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës u ndikua nga shprehja e qëndrimeve divergjente nga anëtarët e saj individualë për një numër çështjesh nën kompetencën e saj për politikën e jashtme. Këshilli i Ministrave miratoi strategji të mëtejshme për mbarë vendin, në fusha të tilla si mjedisi dhe zhvillimi rural. Sidoqoftë, me përjashtim të disa reformave dhe miratimit të shënuar të legjislacionit të akcizave, realizimi i një numër reformash u vonua nga mungesa e marrëveshjes mes anëtarëve të koalicionit qeverisës. Ende nuk janë miratuar strategjitë mbarëkombëtare në fusha të tilla si energjia, punësimi apo menaxhimi i financave publike. Mekanizmi i koordinimit për çështjet e BE-së ka filluar të funksionojë që nga qershori 2017 me përgatitjen e përgjigjeve të vendit në Pyetësorin e Opinioneve të Komisionit. Ende duhet të miratohet një program kombëtar për përafrimin ligjor të vendit me *acquis-në* e BE-së.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme me reformën e **administratës publike** dhe nuk është arritur asnjë përparim gjatë vitit të kaluar. Është duke u zhvilluar një strategji e gjerë për reformën e administratës publike, e cila mbetet të miratohet. Fragmentimi i mëtejshëm i shërbimit civil në njësitë e Federatës dhe në nivelin kantonal, ka rritur rrezikun e politizimit. Bosnja dhe Hercegovina ka një nivel të përgatitjes në lidhje me **sistemin e saj gjyqësor**. Janë bërë disa përparime në lidhje me gjyqësorin, por në përgjithësi, reformat përparojnë me ritëm të ngadaltë. Çdo rishikim i kodit procedural penal duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nuk duhet të dobësojë aftësinë e institucioneve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin apo sfidat e tjera të sundimit të ligjit. Ekziston edhe një nivel përgatitjeje në lidhje me **luftën kundër korrupsionit**. Sidoqoftë, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet çështje shqetësuese. Bosnja dhe Hercegovina ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër krimit të organizuar**. Disa përparime janë bërë, sidomos duke miratuar një strategji të re për luftimin e krimit të organizuar dhe përmbushjen e planit të veprimit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si rezultat i të cilave Bosnja dhe Hercegovina nuk do të jetë më subjekt i monitorimit të Task Forcës së Veprimit Financiar. Sidoqoftë, janë të nevojshme përpjekje domethënëse në lidhje me hetimet financiare dhe përmirësimin e kapaciteteve për të luftuar terrorizmin, si për dhe rritjen e bashkëpunimit me vendet fqinje për çështjet e menaxhimit të kufirit.

Janë arritur disa përparime në çështjet e **të drejtave të njeriut** dhe pakicave. Sidoqoftë, kornizat strategjike, ligjore, institucionale dhe politike për respektimin e të drejtave të njeriut kanë nevojë për përmirësime thelbësore. Kjo përfshin **lirinë e shprehjes** ku vazhdojnë presionet politike dhe kërcënimet e gazetarëve, duke përfshirë sulmet fizike dhe verbale. Mungesa e zbatimit efektiv të legjislacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga **dhuna në baza gjinore**, sidomos dhuna në familje, mbetet shqetësuese. Kërkohet një qasje më gjithëpërfshirëse dhe e integruar për popullatën **rome** për të nxitur përfshirjen e tyre sociale.

Harmonizimi i Bosnjë dhe Hercegovinës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së ende nuk është përmirësuar.

Sa i përket **zhvillimit ekonomik dhe konkurrueshmërisë**, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë disa përparime, por është ende në fazën e hershme të krijimit të një ekonomie tregu funksionale. Janë arritur disa përmirësime në mjedisin e biznesit dhe është forcuar sektori financiar. Çështjet kyçe të mbetura janë sundimi i dobët ligjor, mjedisi ende i varfër i biznesit, administrata publike e fragmentuar dhe joefikase dhe pabarazitë e mëdha të tregut të punës, të lidhura me një sistem të dobët arsimor, kapacitete të dobëta institucionale dhe një klimë investimi jo mbështetëse. Për më tepër, ekonomia informale mbetet e përhapur.

Bosnjë dhe Hercegovinë ka arritur disa përparime dhe mbetet në fazë të hershme sa i përket krijimit të kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. Niveli i përgjithshëm i arsimit dhe shpenzimet për hulumtimin dhe zhvillimin kanë mbetur të ulëta. Cilësia e kapitalit fizik vuan nga nën-investimet. Infrastruktura e transportit dhe energjisë nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Shpejtësia e përshtatjes strukturore ka qenë e ngadaltë, megjithëse ka pasur një diversifikim në strukturën rajonale të tregtisë së vendit.

Duhet ende të forcohet kapaciteti i menaxhimit të **migracionit**, veçanërisht në trajtimin e grupeve të cënueshme. Bosnja dhe Hercegovina duhet të vendosë një mekanizëm kthimi për emigrantët e parregullt.

Kosova

Sa i përket **kritereve politike**, Kosova mbajti zgjedhje të parakohshme në qershor 2017. Kuvendi i ri dhe qeveria e re e morën detyrën në shtator. Sidoqoftë, deri më tash koalicioni i ri qeverisës ka pasur sukses të kufizuar në shtyrjen përpara të reformave të lidhura me BE-në dhe gjetjen e konsensusit për çështjet kyçe strategjike për Kosovën. Fragmentimi dhe polarizimi i vazhdueshëm politik kanë ndikuar negativisht në rolin e Kuvendit, si dhe kanë ndikuar në efektivitetin e qeverisë. Sjellja penguese e disa parlamentarëve, duke përfshirë edhe përdorimin e gazit lotsjellës, ka penguar punën e Kuvendit. Ratifikimi i marrëveshjes së kufirit/demarkacionit të kufirit me Malin e Zi në mars 2018 ishte një përparim i rëndësishëm.

Zgjedhjet parlamentare dhe komunale, të mbajtura në vitin 2017, ishin përgjithësisht konkurruese dhe të mirë-administruara në shumicën e lokacioneve në Kosovë. Sidoqoftë, përbëjnë shqetësim format e frikësimit në shumë komunitete të serbëve të Kosovës, duke synuar në veçanti kandidatët që nuk i përkasin Partisë Lista Srpska.

Konteksti i Kosovës veriore paraqet sfida të veçanta. Hetimi i vrasjes së politikanit serb të Kosovës Oliver Ivanović në janar 2018 vazhdon.

Përpjekjet e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës në dhjetor 2017 për të shfuqizuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar kanë ngritur shqetësime serioze. Do të jetë thelbësore që Kosova t'i përmbushë plotësisht detyrimet e saja ndërkombëtare në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar, si dhe të tregojë përkushtim të plotë dhe pa mëdyshje ndaj këtyre institucioneve.

Është arritur një nivel i përgatitjes në fushën e **reformës së administratës publike**. Janë arritur disa përparime sidomos përmes shqyrtimit e agjencive dhe organeve (gjysmë) të pavarura. Politizimi i vazhdueshëm i administratës publike mbetet shqetësues dhe ndikon negativisht në efikasitetin dhe pavarësinë profesionale të administratës publike.

Sistemi gjyqësor i Kosovës është në një fazë të hershme. Janë arritur disa përparime në zbatimin e ligjeve të paketës së drejtësisë të vitit 2015. Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës dhe personelit të tyre mbështetës në sistemin gjyqësor të Kosovës ishte një arritje e madhe e vitit 2017. Gjyqësori është ende i cënueshëm nga ndikimet e papërshtatshme politike dhe institucioneve të sundimit të ligjit u duhen përpjekje të qëndrueshme për të ndërtuar kapacitetet e tyre. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas.

Kosova është në një fazë të hershme në **luftën kundër korrupsionit**. Kosovë përparim edhe në lidhje me rezultatet e hetimit dhe ndjekjes penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë dhe lëndët e krimit të organizuar, dukë përfshirë dënimet e formës së prerë. Është arritur përparim edhe në konfiskimin paraprak të aseteve, edhe pse konfiskimet e formës së prerë mbeten të ulëta. Korrupsioni është i përhapur dhe mbetet çështje shqetësuese. Kërkohen përpjekje të përbashkëta për ta trajtuar këtë problem në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike.

Kosova është në një fazë të hershme në **luftën kundër krimit të organizuar**. Janë arritur disa përparime në lidhje me korrupsionin e nivelit të lartë dhe lëndët e krimit të organizuar. Edhe pse ka më shumë konfiskim paraprak të aseteve, ka edhe disa dënime të formës së prerë, hetime financiare dhe konfiskime të formës së prerë të aseteve. Agjencitë e zbatimit të ligjit e kanë të vështirë ta luftojnë në mënyrë efektive krimin e organizuar në veriun e Kosovës. Janë arritur disa përparime në luftën kundër terrorizmit, duke përfshirë masat për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, si dhe për të pjesëmarrjen e qytetarëve në konflikte jashtë vendit. Autoritetet e Kosovës duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe ligji përkatës duhet të jetë në harmoni me *acquis-në* e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare.

Korniza ligjore përgjithësisht garanton mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe atyre themelore** në harmoni me standardet evropiane. Sidoqoftë, kërkohen përpjekje shtesë për zbatimin. Zbatimi i strategjive dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut shpesh dëmtohet nga papërshtatshmëria e burimeve financiare dhe e burimeve të tjera, veçanërisht në nivel lokal, priorizimi i kufizuar politik dhe mungesa e koordinimit. Duhet bërë më shumë për të garantuar në mënyrë efektive të drejtat e personave që u përkasin pakicave, përfshirë romët dhe ashkalinjtë dhe personat e zhvendosur, për të siguruar barazinë gjinore në praktikë, për të krijuar një sistem të integruar të mbrojtjes së fëmijëve dhe për të avancuar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Kosova ka arritur një nivel të përgatitjes në fushën e **lirisë së shprehjes**, e cila është e sanksionuar në Kushtetutë. Kosova përfiton nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Sidoqoftë, kanë vazhduar kërcënimet dhe sulmet kundër gazetarëve. Kuvendi ka treguar përkushtim të kufizuar në gjetjen e një zgjidhjeje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë atë të cenueshëm nga presioni politik.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova ka arritur përparim të mirë dhe është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale tregu. Është përmirësuar mjedisi i biznesit dhe qeveria i është përmbajtur rregullës fiskale për deficitin buxhetor; megjithatë, përfitimet e veteranëve të luftës vazhdojnë të përbëjnë një sfidë për financat publike. Ekonomia informale mbetet e përhapur. Përfitimet e punësimit nuk përputhen me rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, kështu që shkalla e papunësisë u rrit më tej. Kjo ka prekur veçanërisht gratë, të rinjtë dhe punëtorët e pakualifikuar. Pavarësisht rritjes së fortë të eksporteve, deficitin i lartë tregtar pasqyron një bazë të dobët të prodhimit.

Kosova ka arritur disa përparime dhe është në një fazë të hershme sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Nuk është arritur asnjë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajtimin e hendekëve të shkathtësive në tregun e punës. Kosova ka arritur disa përparime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por mbeten hendekët e thellë të infrastrukturës në sektorët e hekurudhave dhe energjisë. Ndryshimet strukturore në ekonomi janë të ngadalta, pasi mbeten të varura nga sektori i tregtisë me pakicë. Integrimi me BE-në pengohet nga zbatimi i ngadalshëm i MSA-së.

Kosova vazhdoi përpjekjet e saja për të pasur marrëdhënie të mira dhe konstruktive **bilaterale** me vendet e tjera të zgjerimit. Kosova është e përfaqësuar në shumicën e organizatave rajonale që i përkasin fushëveprimit të Marrëveshjeve për Përfaqësimin Rajonal dhe Bashkëpunimin të dakorduara mes Beogradit dhe Prishtinës në vitin 2012.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova ka qëndruar e angazhuar në dialog. Sidoqoftë, Kosova duhet të ndërmarrë përpjekje të mëtejshme të qenësishme për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe të kontribuojë në krijimin e rrethanave që ndihmojnë për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, që do të përcaktohen në një marrëveshje ligjrisht të detyrueshme.

Sa i përket harmonizimit me **standardet evropiane**, Kosova është në një fazë të hershme. Harmonizimi legjislativ ka vazhduar në disa fusha, por zbatimi është i dobët. Janë arritur disa

përparime në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, të prokurimit publik dhe konkurrencës, si dhe në përmirësimin e mjedisit të biznesit. Në fushën e tatimeve dhe doganave është arritur pak përparim në mbledhjen e të ardhurave dhe thjeshtimin e procedurave administrative, por Kosova duhet të forcojë luftën kundër ekonomisë informale dhe evazionit fiskal. Sektori i energjisë vazhdon të përballlet me sfida serioze. Nuk është arritur asnjë përparim në trajtimin e çështjeve mjedisore. Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet e veta administrative dhe koordinimin, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatimin efektiv të *acquis-së*.

Autoritetet kanë arritur përparim në menaxhimin e **migrimit** të rregullt dhe të parregullt. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë dhe të plotësohen. Kosova duhet të vendosë një mekanizëm kthimi për migrantët e parregullt.

Shtojca 2 - Statistikat kyçe

TË DHËNA STATISTIKORE (të datës
15.02.2018

Demografia	Shënim	Mali i Zi		IRJ e Maqedonisë		Shqipëria		Serbia		Turqia		Bosnjë dhe Hercegovina		Kosova*		BE-28	
		2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Popullsia totale (mijë)		622.1	622.2	2 069.2	2 071.3	2 892.3e	2 886.0	7 114.4	7 076.4	77 696	78 741	3 825.3	3 516.0	1 804.9	1 771.6	508 504	510 279
Pjesa e grupmoshës		67.8	67.6	70.5	70.3	69.1e	69.5	67.1	66.6	67.8	67.8	:	p	:	65.6p	p	bp
15-64 në popullsinë e përgjithshme (%)		1.7	1.8	1.3	1.2	3.6e	:	-5.4	-5.1	11.8	11.2	:	-1.8p	9.2p	:	-0.2ep	0.0bep
Norma bruto e ndryshimit natyror të popullsisë (për 1 000 banorë)		74.4	:	73.5	:	76.2e	:	72.8	:	75.4	:	:	:	:	:	77.9ep	:
Jetëgjatësia në lindje, meshkujt (vite)		78.6	:	77.4	:	79.7e	:	77.9	:	81.0	:	:	:	:	:	83.3ep	:
Jetëgjatësia në lindje, femrat (vite)																	

Tregu i punës	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20-64 vjeç: përqindja e popullsisë 20-64 vjeçare që është ekonomikisht aktive (%)	1)	68.5	69.1	70.2	69.6	71.3e	73.3e	68.1	70.0	59.9	60.9	59.2	58.8	42.8	44.0	77.1	77.5
Shkalla e aktivitetit ekonomik për meshkuj të moshës 20-64 vjeç: përqindja e meshkujve 20-64 vjeç që janë ekonomikisht aktivë (%)	1)	74.9	76.7	83.8	83.8	81.8e	82.5e	76.7	78.0	82.7	83.3	71.9	72.0	65.1	66.8	83.4	83.7
Shkalla e aktivitetit ekonomik për femra të moshës 20-64 vjeç: përqindja e femrave 20-64 vjeç që janë ekonomikisht aktive (%)	1)	62.1	61.6	56.2	54.9	61.1e	64.2e	59.5	62.0	37.3	38.5	46.3	45.3	20.4	20.9	70.8	71.4
Normat e punësimit, mosha 20-64 vjeç (% e popullsisë)																	
Gjithsej		56.7	57.1	51.9	53.3	59.3e	62.1e	56.0	59.1	53.9	54.3	43.2	44.2	29.1	32.3	70.0	71.0

Meshkuj		61.9	51.3	61.5	63.7	68.1e	69.4e	63.7	66.3	75.3	75.5	53.9	56.4	44.9	49.9	75.8	76.8
Femra		51.5	63.0	42.1	42.5	50.7e	55.0e	48.3	51.9	32.6	33.2	32.4	32.0	13.2	14.6	64.2	65.3
Personat e moshës 15-24 vjeç pa punësim, arsim apo aftësim,% e popullsisë në grupmoshën		19.1	18.4	:	:	29.6	26.9e	19.9	17.7	24.0	24.0	27.7	26.4	31.4	30.1	12.0	11.6
Personat e moshës 15-29 vjeç pa punësim, arsim apo aftësim,% e popullsisë në grupmoshën		23.4	22.3	:	:	32.8	30.0e	24.5	22.3	28.0	27.8	32.8	31.4	39.2	37.3	14.8	14.2
Punësimi sipas sektorëve																	
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		7.7	7.7	17.9	16.6	41.3e	40.2e	19.4	18.6	20.6	19.5	17.9	18.0	2.3	4.2	4.5	4.3
Industria (%)		10.8	9.8	23.4	23.1	11.6e	12.8e	19.9	20.2	20.0	19.5	22.0	22.7	18.7	18.0	17.3	17.3
Ndërtimi (%)		6.6	7.7	7.1	7.2	6.9e	6.5e	4.5	4.3	7.2	7.3	7.5	8.6	9.5	11.5	6.8	6.7
Shërbimet (%)		74.8	74.8	51.6	53.1	40.2	40.5	56.1	57.0	52.2	53.7	52.6	50.8	69.5	66.3	71.4	71.6
Personat e punësuar në sektorin publik si pjesë e punësimit total, persona të moshës 20-64 vjeç (%)	2)	32.4	31.2	:	:	16.7e	15.6e	29.7	28.3	13.5	13.8	31.2	29.0	32.6	30.8	:	:
Personat e punësuar në sektorin privat si pjesë e punësimit total, personat e moshës 20-64 vjeç (%)	2)	46.6	47.0	:	:	83.3e	84.4e	70.3	71.7	86.5	86.2	63.2	65.9	67.4	69.2	:	:
Shkalla e papunësisë (% e fuqisë punëtore)																	
Gjithsej	1)	17.5	17.8	26.1	23.7	17.1e	15.2e	17.8	15.4	10.3	10.9	27.9	25.5	32.9	27.5	9.4	8.6
Meshkuj	1)	17.7	18.3	26.7	24.4	17.1e	15.9e	16.9	14.8	9.3	9.6	25.9	22.6	31.8	26.2	9.3	8.4
Femra	1)	17.3	17.1	25.1	22.7	17.1e	14.4e	18.8	16.2	12.6	13.6	30.9	30.2	36.6	31.7	9.5	8.8
Të rinjtë, të moshës 15-24 vjeç	1)	37.6	35.9	47.3	48.2	39.8e	36.5e	43.2	34.9	18.4	19.5	62.3	54.3	57.7	52.4	20.3	18.7
Afatgjatë (> 12 muaj)	1)	13.6	13.4	21.3	19.2	11.3e	10.1e	11.4	10.0	2.2	2.2	22.8	21.7	23.8	18.0	4.5	4.0
Pagat dhe rrogat nominale mujore mesatare (EURO)	3)	480	499	356	363	386	397	506	516	604	:	424	429	:	:	:	:

Arsimi	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Të larguarit e hershëm nga arsimi dhe trajnimi: përqindja e popullsisë 18-24 vjeç me më së shumti arsim të mesëm të ulët dhe jo më tej		5.7	5.5	11.3p	9.9	21.3e	19.6e	7.4	7.0	36.7	34.3	5.2	4.9	14.5	12.7	11.0	10.7

arsimi dhe aftësimi(%)																	
Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV-në (%)	:	:	:	:	3.1p	3.1p	4.0	3.9	4.3	4.6	:	:	4.5	4.7p	:	:	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me arsim të mesëm të ulët, gjithsej	6.6	6.8	:	:	:	:	8.6	7.8	46.5	43.9	6.2u	5.8u	:	14.6	17.2	16.8	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me arsim të mesëm të ulët, meshkuj	6.9	5.8	:	:	:	:	9.3	8.6	46.2	44.2	5.6u	5.	:	12.5	19.4	19.1	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me më së shumti arsim të mesëm të ulët, femra	6.3	7.9	:	:	:	:	7.9	7.0	46.8	43.7	6.9u	6.3u	:	17.0	14.9	14.4	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me arsim të mesëm të lartë ose arsim jo-terciar, gjithsej	80.6	82.2	:	:	:	:	83.2	84.9	34.9	35.7	86.3	86.6	:	70.5	65.2	65.3	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me arsim të mesëm të lartë ose jo-terciar, meshkuj	85.3	86.9	:	:	:	:	84.5	86.3	37.8	38.3	88.6	89.0	:	74.5	65.9	66.1	
Përqindja e popullsisë së moshës 20-24 vjeç me arsim të lartë të mesëm ose jo-terciar, femra	75.7	77.2	:	:	:	:	81.7	83.3	32.2	33.3	83.5	83.7	:	66.0	64.5	64.5	
Përqindja e popullsisë së moshës 30-34 vjeç me arsim terciar, gjithsej	31.0	33.9	28.6	29.1	22.1e	20.9e	28.9	29.9	23.5	26.5	17.2	23.1	17.2	19.1	38.6	39.0	
Përqindja e popullsisë së moshës 30-34 vjeç me arsim terciar, meshkuj	29.9	31.8	23.1	24.5	19.6e	18.0e	24.2	24.7	25.0	28.3	13.4u	16.6u	19.5	18.9	33.9	34.3	
Përqindja e popullsisë së moshës 30-34 vjeç me arsim terciar, femra	32.2	35.9	34.5	33.8	24.7e	23.9e	33.7	35.3	22.1	24.6	21.3	29.4	14.7	19.4	43.3	43.8	

Llogaritë kombëtare

	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Bruto Prodhimi Vendor																	
Në çmime aktuale (miliardë)		3.	4.0	9.1	9.7p	10.2p	10.7p	33.5	34.6	773.0	780.2	14.6	15.3	5.8	6.0p	14 797.4	14 907.9
Për kokë (EURO)		5 827	6 355	4 382	4 691	3 547	3 728	4 720	4 904	9 949	9 909	4 312	4 494	3 278	3 304	29 033	29 148
Sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS) për kokë banori		12 200	13 000	10 500	10 900	8 500	8 500	10 500	10 700	18 900	18 800	9 100	9 300	:	:	29 000	29 100
Sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS) për kokë banori, në krahasim me mesataren e BE-së (BE-28 = 100)		4 2	45	36	37	29	29	36	37	65	64	31	32	:	:	-	-
Norma reale (vëllimi) vjetore e ndryshimit në krahasim me vitin paraprak (%)		3. 4	2.9	3.9	2.9p	2.2p	3.4p	0.8	2.8	6.1	3.2	3.1	3.3	4.1	3.4p	2.3	2.0
Vlera bruto e shtuar nga sektorët kryesorë																	
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		9. 7	9.0	11.1	10.5p	22.9p	22.9p	8.2	7.9	7.8	7.0	7.3	:	12.6	13.4p	1.5	1.5
Industria (%)		12.8	12.3	19.3	19.9p	13.9p	13.2p	25.9	25.9	22.4	22.3	21.9	:	20.8	21.1p	19.4	19.4
Ndërtimi (%)		4.	6.8	8.1	8.6p	10.2p	10.5p	5.5	5.4	9.3	9.7	4.6	:	8.4	8.2p	5.3	5.3
Shërbimet (%)		73.0	71.9	61.5	61.0p	53.0p	53.4p	60.4	60.8	60.5	61.0	66.2	:	58.2	57.3p	73.8	73.8

Bilanci i pagesave

	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Neto Investimet e Huaja Direkte (hyrëse - dalëse) (IHD) (milion euro)		619.3	371.6	202.8	316.9	818.4	936.5	1 803.8	1 899.2	:	:	248.9	240.5	271.8	177.2	-129 867	-116 465
Investimet e huaja direkte neto (IHD) (% e BPV-së)		16.9	9.4	2.2	3.3p	8.0p	8.7p	5.4	5.5	:	:	1.7	1.6	4.7	3.0p	-0.9	-0.8
Neto Investimet e Huaja Direkte (hyrëse - dalëse) (IHD) në krahasim me BE-28 (milion euro)		403.0	-32.5	-20.7	199.1	:	:	1 480.4	1 304.4	:	:	160.5	190.9	11.2	15.6	-	-
Neto Investimet e Huaja Direkte (hyrëse - dalëse) në krahasim me BE-28 (% e BPV-së)		11.0	-0.8	-0.2	2.0p	:	:	4.4	3.8	:	:	1.1	1.2	0.2	0.3p	-	-
Remitancat si % e BPV-së		1.	1.0	2.3	2.0p	5.9p	5.7p	8.5	7.8	:	:	8.3	8.2	11.5	11.5p	0.1	0.1

Tregti e jashtme në mallra

	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Tregtia ndërkombëtare e																	
Pjesa e eksporteve në vendet e BE-28 në vlerën e eksporteve totale (%)		35.6	37.4	77.0	79.9	75.4	77.9	67.0	67.6	44.5	47.9	71.6	71.3	32.6	22.6	-	-

Pjesa e importeve nga vendet e BE-28 në vlerën e importeve totale (%)		41.3	48.2	62.0	62.0	61.8	63.1	57.3	58.7	38.0	39.0	60.8	61.9	42.2	43.1	-	-
Bilanci tregtar (milionë EURO)		-1 524	-1 736	-1 714	-1 777	-2 154	-2 399	-2 978	-2 483	-56 981	-50 676	-3 510	-3 448	-2 309	-2 480	59 553	32 002
Tregtia ndërkombëtare e mallrave dhe shërbimeve në raport me BPV-në																	
Importet (% e BPV-së)		60.6	62.9	65.0	64.7p	44.7p	:	56.4	57.5	26.0	24.9	53.2	52.3	49.5	51.3p	40.3	40.5
Eksportet (% e BPV-së)		42.1	40.5	48.7	50.0p	27.4p	:	46.7	50.0	23.3	22.0	34.6	35.4	19.3	22.5p	43.8	44.0

Financat Publike	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Statistikat e financave të qeverisë, në raport me BPV-në																	
** Teprica e përgjithshme e qeverisë (+) / deficitit (-) (%)		-7.4	-2.8	-3.5	-2.7	-4.1	-1.8	-3.7	-1.3	1.3	:	0.7	1.2	:	:	-2.4	-1.7
** Borxhi i përgjithshëm i qeverisë (%)		66.2	64.4	38.1	39.6	69.1	68.7	76.0	73.0	27.5	:	41.9	40.5	12.8	:	84.5	83.2

Treguesit financiarë	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Ndryshimi vjetor i çmimeve të konsumit (%)	4)	1.4	0.1	-0.3	-0.2	2.0	2.5	1.5	1.3	7.7	7.7	-1.0	-1.1	-0.5	0.3	0.0	0.3
Gjithsej borxhi i jashtëm, në raport me BPV-në (%)		:	:	69.3	74.2p	74.7p	73.5p	78.3	76.5	47.1	:	72.2	71.0	33.3	33.7p	:	:
Norma e interesit të kredisë (një vit), në vit (%)	5)	:	:	:	:	74.7	73.5	:	:	53.0	:	:	:	:	:	:	:
Norma e interesit të depozitave (një vit), në vit (%)	6)	8.53	7.45	3.75	4.25	7.77	5.89	6.50	5.50	10.79	:	5.74	4.97	8.32	7.47	:	:
Vlera e mjeteve të rezervës (duke përfshirë arin) (milion EUR)	7)	1.23	0.93	0.25	0.25	1.35	0.80	2.50	2.50	7.27	:	0.09	0.09	0.90	1.01	:	:
Rezerva ndërkombëtare - ekuivalenca në muaj të importeve		673.7	803.0	2 261.8	2 613.4	2 880.0	2 945.0	10 378.0	10204.6	99 619.6	:	4 414.6	4 887.4	706.4	605.1	:	:

Biznesi	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Indeksi i prodhimit industrial (2010 = 100)	8)	88.3	84.4	118.0	122.0	161.7	130.5	107.1	112.1	124.1	126.3	107.4	112.0	:	:	103.9	105.6

Infrastruktura	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat në operim për		18.1	18.1	28.1	27.4	13.8	12.2	48.6	48.6	13.2	:	20.1	21.9	30.9	30.9	:	:

mijë km ²)																	
Gjatësia e autostradave (kilometra)		0	0	259	259	:	:	693	741	2 282	2 542	128	:	80	98	:	:

Energjia	Shënim	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
Importet neto të energjisë në raport me BPV-në		4.2	3.4	6.4	5.1p	0.8p	1.3p	4.8	3.6	1.2	1.0	5.3	4.3	5.4	4.1p	1.6	1.3

: = i padisponueshëm
b = shkëputje në seri
e = vlera e parashikuar p = e përkohshme
u = besueshmëria e ulët
- = nuk aplikohet

*= Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës
** = Të dhënat e deficitit qeveritar dhe të borxheve të vendeve të zgjerimit publikohen "siç janë" dhe pa ndonjë siguri për cilësinë dhe respektimin e rregullave të ESA-së.

Shënimet:

- 1) Turqia: papunësia bazuar në kriterin 4 javë + duke përdorur vetëm metoda aktive të kërkimit të vendeve të punës.
- 2) Bosnja dhe Hercegovina: pjesët nuk mbledhen në 100%, sepse llojet e tjera të pronësisë janë të përjashtuara. Mali i Zi: përjashton OJQ-të; të dhënat i referohen numrit të punonjësve (në sektorin privat apo publik) si pjesë e numrit të përgjithshëm të personave të punësuar.
- 3) Shqipëria: sektori publik. Bosnja dhe Hercegovina: të ardhurat neto. Serbia: pagat dhe mëditjet që u paguhen punonjësve të personave juridikë dhe ndërmarrjeve të painkorporuara.
- 4) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit me përjashtim të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe të dhënave të vitit 2015 për Shqipërinë. Shqipëria: ndryshimi mes dhjetorit të një viti dhe dhjetorit të vitit të kaluar.
- 5) Borxhi i jashtëm i Shqipërisë (duke përfshirë IHD-të).
- 6) Shqipëria: norma mesatare e peshuar e aplikuar për kreditë e reja 12-mujore gjatë muajit përkatës, me maturim 12-mujor. Bosnja dhe Hercegovina: normat afatshkurtra të huadhënies në monedhën vendase për korporatat jofinanciare (mesatarja e peshuar). Mali i Zi: norma mesatare efektive e peshuar e interesit, shumat e papaguara, vjetore. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: fundi i vitit (31 dhjetor).
- 7) Shqipëria: norma e interesit të depozitave përfaqëson normën mesatare të peshuar për depozitat e reja të pranuar gjatë muajit përkatës, me maturim 12-mujor. Bosnja dhe Hercegovina: normat e depozitave të kërkesës në monedhën vendase të amvisërive (mesatarja e peshuar). Mali i Zi: norma mesatare efektive e peshuar e interesit, shumat e papaguara, vjetore. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: fundi i vitit (31 dhjetor). Turqia: struktura e depozitave njëditore.
- 8) Mali i Zi dhe Serbia: seria bruto, në vend të kalendarit të përshtatur.